



RAPORT AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE USHTRUAR NË DREJTORINË E
PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË
BRENDSHME, TIRANË

Titulli: “Mbi zbatimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara”.

Subjekti: Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë.

Përgatitur: 08.9.2017

Auditimi është kryer ne bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.618/2, prot, datë 08.6.2017, me objekt: “Mbi zbatimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara”.

Auditimi u krye nga:

- | | | |
|-------------|---------|-------------------|
| 1. Miranda | HAXHIA, | përgjegjës grupi, |
| 2. Brunilda | ZENELI, | anëtar, |
| 3. Melina | KABO | anëtar, |

Auditimi ka filluar me 12.6.2017

Auditimi ka përfunduar me 28.7.2017



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
1	Përmbledhje	3-6
2	Hyrje	6
3	Qëllimi dhe procesi i auditimit	6-7
4.	Rezultatet e Auditimit: 1.Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme. 2.Mbi auditimin e fondeve të programuara dhe të realizuara në përputhje me Regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, përllogaritja e nevojave. 3.Mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës limit të kontratës. 4.Hartimi i dokumenteve të tenderit 5.Zhvillimi i procedurave të prokurimit nga njoftimi i kontratës deri të publikimi njoftimit të shpalljes së fituesit. 6.Të tjera të dala nga procesi i auditimit.	7-9 9-10 10-14 14-26 26-43
5.	Opinion i Audituesit	43
6.	Konkluzionet dhe Rekomandimet	43-49
7.	Tabela e Shkurtimeve	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Përmbledhje

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e më poshtë KLSH) në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 618/2, prot, datë 08.6.2017, me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara”, realizoi misionin e auditimit në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara (këtu e më poshtë DPP) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2016 deri më 31.12.2016.

Auditimi i kushtoi vëmendje të posaçme, çështjeve që lidhen procedurat e prokurimit publik për vitin 2016, si hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e fondit limit, hartimi i dokumenteve të tenderit etj.

Misioni i auditimit u realizua me objekt “Përputhshmërie”. Gjatë këtij auditimi është verifikuar dokumentacioni me zgjedhje. Përveç auditimit të dokumentacionit, auditimi është bazuar edhe në këshillimin dhe ballafaqimet me stafin drejtues dhe atë administrativ të subjektit të audituar.

Në përfundim të auditimit, me personat përkatës dhe ato përgjegjës në DPP, u mbajtën aktverifikime dhe pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e këtyre punonjësve, janë marrë në konsideratë ato që kishin argumentim e mbështetje ligjore, mbi këtë bazë u përgatit dhe u paraqit Projektraporti i auditimit i cili iu dergua subjektit të audituar. Me shkresën nr. 4422/6, datë 02.8.2017 protokolluar në KLSH me nr. 618/2, datë 02.8.2017 u paraqitën nga subjekti observacionet mbi aktverifikimet e mbajtura si dhe me shkresën nr. 4422/8, datë 05.9.2017 protokolluar në KLSH me shkresën nr.618/4 datë 06.9.2017, subjekti ka paraqitur observacione rreth Projektraportit të cilat nga përmbajtja parashtrojnë të njëjtat qëndrime dhe nuk kanë asnjë argument të ri të shoqëruar me dokument. Pasi u shqyrtuan observacionet nga grupi i auditimit duke u marrë për bazë ato që kanë mbështetje ligjore, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi. Në mënyrë të përmbledhur më poshtë jepen gjetjet:

-Mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës limit të kontratës, konstatohet se:

- ✓ DPP duke qënë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nxjerr Urdhër Prokurimin për kryerjen e procedurave të tenderit i cili përmban ndër të tjera sipas nenit 60 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, dhe fondin limit. Pikërisht në këtë fazë konstatohet se nga DPP nuk bëhen verifikimet e domosdoshme mbi angazhimin e fondeve buxhetore në planet vjetore të miratuara të buxhetit të cdo Autoriteti Kontraktor (AK), kjo për shkak të mungesës së informacionit të dërguar nga AK si dhe mos bashkëpunimit të Organit Qendror Blerës (OQB), Ministria e Punëve të Brendshme me këto autoritete në këtë aspekt.
- ✓ Disa AK, i kanë paraqitur me vonesë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin përkatës, në tejkalim të afatit të përcaktuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3.
- ✓ Për përcaktimin e fondit limit në procedurën e prokurimit “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh” me fond limit 128,113,807 lekë (pa TVSH), OE kanë dërguar ofertat e tyre së bashku me specifikimet teknike për artikujt përkatës. Po ti referohemi datave të paraqitjes së kërkesave nga AK, mbi llojin e artikujve, specifikimet teknike dhe fondin limit të tyre, ato në zbatim të VKM-së nr. 28, datë 14.01.2015, kanë afatin e dorëzimit të tyre deri më datë 31.01.2016. Gjithashtu, një pjesë e tyre i kanë sjellë me vonesë kërkesat përtej këtij afati. Për rrjedhojë, dalja e urdhrat të titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për testimin e tregut, është bërë paraprakisht dhe pa patur dijeni mbi kërkesat e AK,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

mbi llojin artikujve që kërkojnë, specifikimet teknike etj, si dhe dërgimi për referencë AK, është në tejkalim të kompetencave që aktet ligjore dhe nënligjore i kanë dhënë OQB.

- Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, konstatohet se:

- ✓ Për **vitin 2016**, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, në cilësinë e organit qendror blerës (OQB) bazuar në VKM-së nr. 28, datë 14.01.2015, me ndryshime, pika 4 dhe Udhëzimin e APP nr.1, datë 27.1.2015, pika 2, bën mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike dërguar nga AK, ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave që prokurohen si dhe vlerën e përllogaritur të fondit limit Bazuar në nenin 60 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, nxjerr urdhë prokurimin i cili përmban dhe vlerën e fondit limit. Për të konfirmuar nëse Autoritet Kontrataktore kanë të angazhuar fondet në planet e tyre buxhetore, DPP nuk ka bërë asnjë verifikim, minimumi të kërkojë nga këto autoritete shkresat zyrtare të çeljes së fondeve në dispozicion të tyre, pasi duke qënë në cilësinë e një Autoriteti Kontraktor tashmë ajo ka përgjegjësinë dhe detyrimin që rrjedh nga neni 60 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime sipas të cilit, *“me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas llogaritjes së fondit limitnxjerr menjëhersh urdhrin e prokurimit.... i cili duhet të përmbajëfondin e përllogaritur të vitit ushtrimor...”*. Në këtë këndvështrim, DPP në nxjerrjen e fondit limit mjaftohet vetëm me vlerën e fondit limit të dërguar nga Autoritet Kontraktore i cili në shumicën e rasteve nuk ka bashkangjitur shkresat për llogaritjen e tij, duke mos identifikuar/verifikuar angazhimin e fondeve buxhetore të miratuara në dispozicion të Autoriteteve Kontraktore.
- ✓ DPP, nuk disponon një regjistër të të dhënave, i cili të përmbajë të dhënat mbi fondin limit sipas loteve, fondin limit të prokuruar, operatorin ekonomik fitues etj. që të publikohet në faqen zyrtare të APP-së për të mundësuar lehtësisht verifikimin e tyre, mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe fondeve në dispozicion. Ky fakt është konstatuar dhe nga auditimi i mëparshëm por nga ana DPP nuk është zbatuar rekomandimi i KLSH-së në lidhje me të.
- ✓ Në hartimin e dokumenteve të tenderit, disa prej kriterëve të vecanta të kualifikimit për “Kapacitetin Teknik”, që kanë të bëjnë me afatin e garancisë së mallit, ngjyrën e mallit, pajisjen me librezë shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, etj. konkretisht në procedurat e prokurimit: “Blerje automjete”, ndarë në 11 lote, me fond limit/kufi monetar në total sipas loteve 64,066,666 lekë pa TVSH, “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)”, ndarë në 31 lote me fond limit/kufi monetar në total 1,822,592,504 lekë pa TVSH, “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, me fond limit 43,794,015 lekë pa TVSH dhe “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, me fond limit 128,113,807 lekë pa TVSH, nuk janë të njëjta nga njëri lot në tjetrin dhe pse objekti i tenderimit është i njëjtë. Ajo nuk inkurajon pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në konkurim, pasi duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të plotësojnë kërkesat minimale të tyre. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 2, pika c dhe ç, neni 20, 46 si dhe me VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 27/3.
- ✓ Në dy procedura prokurimi dhe konkretisht **“Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”**, me fond limit 128,113,807 lekë dhe 43,794,015 lekë, në kërkesat e vecanta për kualifikim kërkohej vërtetim “për numrin e punëtorëve,.... nga të cilët të paktën 1 punonjës të jetë inxhinier druri”. Një kërkesë e tillë tejkalon objektin e kontratës e cila është “kontratë blerje” dhe jo “kontratë shërbimi”. Kërkesa për inxhinier druri do të ishte e domosdoshme dhe minimale nëse kemi të bëjmë me porositjen për prodhim të pajisjeve për mobilim zyrash dhe jo në rastin e kontratës së blerjes së këtyre pajisjeve. AK nuk duhet që në kërkesat e vecanta për kualifikim, të përfshijn kriterë të cilat nuk janë në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

përpjestim dhe të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës, por duhet të kërkojë që ata të plotësojnë kërkesat minimale. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

-Mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit nga njoftimi i kontratës deri te publikimi njoftimit të shpalljes së fituesit:

- ✓ Në vlerësimin e ofertave KVO ka ndjekur kriterin e vlerësimit të cmimit më të ulët, duke vlerësuar në shumicën e rasteve ofertën me vlerën më të ulët, bazuar dhe në rekomandimet e mëparshme të KLSH, dërguar me shkresën nr. 606/7, datë 4.10.2016.
- ✓ Në shumicën e rasteve në seancën publike të hapjes së ofertave të hedhura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatohet se operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike ose dokumentacionin ligjor/teknik të kërkuar. Pjesmarrja e tyre bëhet vetëm për të siguruar konkurrencën numerike në seancë publike të hapjes së ofertave, duke krijuar mundësinë që konkurimi të fillojë me një operator të vetëm sipas kërkesave të nenit 73, pika 1 VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime. Kjo mënyrë konkurimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues, operatorin e mbetur në garësi e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin Autoriteti Kontraktor (OQB) duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës si organ kompetent i hetimit të konkurrencës së pandershme. Për pasojë, mos publikimi nga operatorët ekonomikë i ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në SPE, kur konstatohen fenomene të tilla nuk krijon kushtet për konkurrencë, nuk nxit dhe nuk inkurajon biznesin e vogël dhe të mesëm, kushti kryesor për realizimin e objektivit dhe qëllimit të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 1, si dhe direktivave të BE
- ✓ Në vlerësimin e ofertave ekonomike, KVO ka marrë në konsideratë dhe ka vlerësuar ofertën e paraqitur nga operatorët ekonomikë dhe pse ajo nuk është plotësuar sipas rubrikave dhe kërkesave të shtojcës 1, të DT, si dhe kërkesave të nenit 17 të ligjit nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, sipas të cilave plotësohet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme çmimesh në ofertën e tij. Një veprim i tillë nga KVO nuk e përjashton atë nga detyrimet e nenit 10, dhe 14 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

-Mbi auditimin e fondeve të programuara dhe të realizuara në përputhje me Regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, përllogaritja e nevojave:

- ✓ **Nuk ka asnjë konfirmim mbi fondet buxhetore të vëna në dispozicion të AK**, për marrjen përsipër të angazhimeve buxhetore. OQB i cili në këtë rast është autorizuar nga AK për kryerjen e procedurave të prokurimit, ka rolin e organit prokurues (zbatues) dhe si i tillë nxjerr urdhrin e prokurimit për vlerën limit të kontratës. Në këto kushte, ky organ përpara se të nxjerrë urdhrin e prokurimit duhet të ketë konfirmimin nga AK mbi vënien në dispozicion të fondeve buxhetore përpara se të marrë këtë angazhim.

-Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme:

- ✓ Rekomandimi 1, 2, 3, 3.2 dhe 4 “Propozime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi”, i është përcjellë APP përmes shkresës me nr. 3624/24, datë 16.03.2017, por nuk i është dërguar asnjë propozim konkret siç edhe citohet në shkresën nr. 3624/25, datë 03.04.2017 “kthim e përgjigje për KLSH”, ndërsa për rekomandimin nr. 3/1, nuk janë shprehur në shkresën informuese të sipërpërmendur. Me shkresën nr.4567/1 Prot. Datë 07.04.2017, APP ka kthyer përgjigje duke dhënë argumenta përse rekomandimet e KLSH nuk mund të përmbushen. Bazuar sa më sipër, 5 rekomandimet për përmirësim ligjor janë marrë në konsideratë nga DPP dhe nga APP por kjo e fundit nuk i ka pranuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

DPP për 6 rekomandime “Masa organizative” me shkresën nr. 3624/25 Prot.datë 03.04.2017 shprehet se:

MPB për rekomandimin 1, po merr masat e nevojshme për zbatimin e tij, por nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se realisht janë marrë masa. Rekomandimi nuk është zbatuar.

Rekomandimi 2 nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore.

Rekomandimi 3 gjykohet rast pas rasti në auditimet që KLSH do të kryejë në vazhdimësi.

Rekomandimi 4 është pranuar dhe mbetet të gjykohet në vazhdimsi zbatimi i tij efektiv.

Rekomandimi 5 është pranuar dhe kjo është faktuar me raste konkrete.

Rekomandimi 6 është pranuar, por arkivimi i dosjeve nuk ka përfunduar.

- ✓ 3 Rekomandime “Masa për përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të fondeve publike”:

DPP në zbatim të rekomandimit 1, ka ngritur grupin e punës për analizimin e shkaqeve, arsyeve dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KVO dhe kanë arritur në konkluzionin se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për rekomandimin 2, DPP ka ngritur grupin e punës dhe ka analizuar përgjegjësitë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe ka arritur në konkluzionin se kjo njësi ka vepruar në përputhje me ligjin dhe rregullat për prokurimin publik dhe KVO ka vepruar në përputhje me kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Grupi i punës që DPP ka ngritur për arsyetuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën 80,845,545 lekë, ka dalë në konkluzionin se anëtarët e njësisë së prokurimit i kanë hartuar në përputhje me ligjin dhe rregullat për prokurimin publik.

Rekomandimi i KLSH për “Masa për përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të fondeve publike” **janë zbatuar.**

Në lidhje me “Masat disiplinore” që KLSH ka rekomanduar DPP-së për të proceduar ndaj punonjësve, ka vendosur të mos fillojë procedimin disiplinor ndaj tyre. Kjo pasi, bazuar në vendimet që mori grupi i punës i sipër përmendur konkludohet se, punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi nga KLSH, kanë vepruar në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

Rekomandimi i KLSH për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësve **nuk është zbatuar.**

Hyrje

Auditimi i ushtruar në DPP, u krye në lidhje me ligjshmërinë e ndjekur në hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit, hartimin e dokumenteve të tenderit dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për vitin 2016, në përdorimin e fondeve për kryerjen e shërbimeve të ndryshme.

Auditimi u mbështet dispozitat ligjore që rregullojnë funksionimin e KLSH dhe DPP-së dhe konkretisht:

Ligji nr 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime, VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, VKM nr.28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë” me ndryshime, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe të gjitha aktet të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e subjektit.

Qëllimi:

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi DPP, duke i kushtuar vemendjen e posaçme çështjeve që lidhen me procesin e prokurimit publik të përqendruar, objekt i veprimtarisë së kësaj drejtorie.

Procesi i auditimit, u krye sipas drejtimeve të mëposhtme:

1. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.
2. Mbi auditimin e fondeve të programuara dhe të realizuara në përputhje me Regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, përllogaritja e nevojave.
3. Mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës limit të kontratës.
4. Hartimi i dokumenteve të tenderit.
5. Zhvillimi i procedurave të prokurimit nga njoftimi i kontratës deri të publikimi njoftimit të shpalljes së fituesit.
6. Të tjera të dala nga procesi i auditimit.

Objektivat e auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit, objektivi kryesor është dhënia e një opinioni nëse nga strukturat përkatëse të këtij institucioni:

- janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi mbi bazën e të cilave funksionon veprimtaria ligjore e këtij institucioni,

- fondet e akorduara nga buxheti i shtetit në funksion të kësaj veprimtarie, janë përdorur konform akteve ligjore në fuqi dhe në mënyrë efektive.

- Një vemendje e veçantë ju kushtua në këtë mision auditimi: vlerësimit të veprimtarisë së DPP, në cilësinë e organit qendror blerës, për kryerjen e të gjithë procedurave të prokurimit të njohura me VKM nr.28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë” me ndryshime, që nga njoftimi i kontratës deri të publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit dhe autorizimin e Autoriteteve Kontraktore për lidhjen e kontratave me operatorin ekonomik fitues, referuar detyrimeve ligjore të nenit 11 të nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar.

REZULTATET E AUDITIMIT:

1. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

(Burimi i të dhënave për auditimin e kësaj pike të programit është marrë nga korrespondenca zyrtare mes DPP dhe KLSH, APP, vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme).

Baza ligjore në auditim.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, u krye bazuar në legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji nr 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Masat e marra nga subjekti për zbatimin e rekomandimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI USHTUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 606/7, datë 04.10.2016, ka dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, për auditimin e ushtuar në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara DPP), pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2015. Në përgjigje të shkresës së KLSH, nga ana e DPP është dërguar shkresa nr. 3624/25, datë 03.04.2017 mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

-Realizimi i tyre.

Në lidhje me pikën A “Propozime për përmirësime në legjislacionin në fuqi”, rekomandimi 1, 2, 3, 3.2 dhe 4, DPP ka vënë në dijeni APP përmes shkresës me nr. 3624/24 Prot. datë 16.03.2017, por nuk i ka dërguar asnjë propozim konkret siç edhe citohet në shkresën nr. 3624/25 “kthim përgjigje për KLSH”. Për rekomandimin nr. 3/1, nuk janë shprehur në shkresën informuese nr. 3624/24, datë 16.03.2017 dërguar APP. Me shkresën nr. 4567/1, datë 07.04.2017 APP ka kthyer përgjigje duke dhënë argumenta përse rekomandimet e KLSH nuk mund të përmbushen.

Bazuar sa më sipër **5 rekomandimet** për përmirësime ligjore janë marrë në konsideratë nga DPP dhe nga APP por APP ka dhënë shpjegimet e veta duke argumentuar si më poshtë:

Rekomandimi 1, i KLSH, **nuk është i nevojshëm** shtimi i parashikimit në VKM nr. 914 dtan 28.12.2014, pasi ky problem është i rregullur nga LPP.

- ✓ Në lidhje me rekomandimin 2 të KLSH, APP e gjykon si **tejkallim kopetencash** të OBQ rishikimin e fondeve të AK.
- ✓ Për sa i përket rekomandimit 3 të KLSH, APP ka argumentuar se referuar nenit 12/1 të LPP dhe udhëzimit të APP-së nr.1, datë 27.01.2015, përcaktimi taksativ i llojit të procedurës që do zhvillojë AK në rast të dështimit të procedurës së prokurimit, **nuk është i nevojshëm** sepse është e drejtë dhe përgjegjësi ligjore e vetë AK, dhe në çdo rast, vlerësohet në bazë të kushteve dhe specifikave konkrete.
- ✓ Rekomandimi 3/2 është **kundërshtuar** me argumentin se legjislacioni për prokurimet publike synojnë përafrimin me direktivat e BE, të cilat nuk parashikojnë asnjë sanksion për OE.
- ✓ Së fundmi propozimi për përcaktimin në VKM nr.914 datë 28.12.2014 që AK të dërgojnë njoftimin e lidhjes së kontratës brenda 3 ditëve në OBQ, **kundërshtohet** me arsyetimin se shkurtimi i afatit nga 5 ditë (pika 6/3, neni 2, VKM nr.914 datë 28.12.2014) nuk do të shmangte vonesat.

Bazuar sa më sipër dalim në përfundimin se rekomandimet e KLSH **nuk janë pranuar**.

Në lidhje me “Masat organizative” ku KLSH ka dhënë 6 rekomandime, DPP në shkresën nr. 3624/25 Prot.datë 03.04.2017 shprehet se:

- ✓ Në lidhje me rekomandimin 1, MPB po merr masat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi, por DPP nuk ka asnjë dokument që të faktojë se realisht janë marrë masa, pra rekomandimi nuk është zbatuar.
- ✓ Rekomandimi 2 i KLSH për krijimin e një regjistri me të dhënat (data kërkesës, sasia e mallrave, punëve apo shërbimeve të kërkuara, fondi limit i parashikuar, fondi limit sipas urdhrit të nxjerrë, vlera e shpallur fituese, emri i operatorit fitues e etj.) e autoriteteve kontraktore nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore.
- ✓ Zbatimi i rekomandimit 3 gjykohet rast pas rasti në auditimet që KLSH do të kryejë në vazhdimësi.
- ✓ Rekomandimi 4 i KLSH është pranuar dhe mbetet të gjykohet në vazhdimësi zbatimi i tij efektiv.
- ✓ Rekomandimi 5 i KLSH është pranuar dhe kjo është faktuar me raste konkrete.
- ✓ Rekomandimi 6 i KLSH është pranuar por arkivimi i dosjeve nuk ka përfunduar.

Në lidhje me “Masat për përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike” DPP ka vepruar si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

- ✓ DPP në zbatim të rekomandimit 1 ka ngritur grupin e punës për analizimin e shkaqeve, arsyeve dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KVO dhe kanë arritur në konkluzionin se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
- ✓ Në lidhje me rekomandimin 2 DPP ka ngritur grupin e punës dhe ka analizuar përgjegjësitë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe ka arritur në konkluzionin se kjo njësi ka vepruar në përputhje me ligjin dhe rregullat për prokurimin publik dhe KVO ka vepruar në përputhje me kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
- ✓ Grupi i punës që DPP ka ngritur për arsyetuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën 80,845,545 lekë, kanë dalë në konkluzionin se anëtarët e njësisë së prokurimit i kanë hartuar në përputhje me ligjin dhe rregullat për prokurimin publik.

Rekomandimi i KLSH për “Masa për përdorimin me efektivitet, efencë dhe ekonomicitet të fondeve publike” **janë zbatuar.**

Në lidhje me “Masat disiplinore” që KLSH ka rekomanduar DPP-së për të proceduar ndaj punonjësve, me anë të vendimeve përfundimtare Nr. 2259/4, datë 23.03.2017, Nr. 2259/5, datë 23.03.2017, Nr. 2259/6, datë 23.03.2017, Nr. 2259/7, datë 23.03.2017, Nr. 2259/8, datë 23.03.2017, Nr. 2259/9, datë 23.03.2017, Nr. 2259/10, datë 23.03.2017, Nr. 2259/11, datë 23.03.2017, kanë vendosur të mos fillojnë procedimin disiplinor ndaj tyre. Kjo pasi, bazuar në vendimet që mori grupi i punës i sipër përmendur konkludohet se punonjësit të ngarkuar me përgjegjësi nga KLSH, kanë vepruar në përputhje me bazën ligjore në fuqi, si dhe arsyetohet në vendimet përkatëse.

Rekomandimi i KLSH për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësve **nuk është zbatuar.**

Konkluzione nga auditimi:

1. Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara me shkresën nr.3624/25, datë 03.4.2017 ka kthyer përgjigje shkresës së KLSH nr.606, datë 4.10.2016 me anë të së cilës dërgohen rekomandimet për auditimin e mëparshëm. Nga zbatimi i rekomandimeve rezulton se DPP ka shqyrtuar rekomandimet duke marrë masa për realizimin e një pjese të tyre. Në përfundim, me qëllim përmirësimin e gjendjes të përsërisim rekomandimin nr.6 , “Masat organizative” dërguar me shkresën nr.606, datë 4.10.2016.

(Për konstatimet e mësipërme është mbajtur Aktverifikimi nr.3, datë 27.7.2017).

2. Mbi auditimin e fondeve të programuara dhe të realizuara në përputhje me Regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, përllogaritja e nevojave.

Baza ligjore në auditim.

-Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”, Neni 51 “Menaxhimi i angazhimeve”;

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 me ndryshime “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

-VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Mbi disiplinimin e angazhimeve buxhetore”;

-VKM nr.28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë” me ndryshime.

Nga auditimi ka rezultuar se në zbatim të VKM nr.28, datë 14.01.2015 me ndryshime, Autoritetet Kontraktore (AK), kanë paraqitur pranë Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara në cilësinë e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Organit Qendor Blerës (OQB) kërkesat për realizimin e procedurës së prokurimit, fondin limit dhe specifikimet teknike.

OQB, mbështetur në kërkesat e AK-ve, ka përcaktuar vlerën limit të kontratës dhe ka nxjerrë urdhrin e prokurimit sipas objektit. Konstatohet se **nuk ka asnjë konfirmim mbi fondet buxhetore të vëna në dispozicion të AK-ve**, për marrjen përsipër të angazhimeve buxhetore. Sa më sipër, OQB i cili në këtë rast është autorizuar nga AK-të për kryerjen e procedurave të prokurimit, ka rolin e organit prokurues (zbatues) dhe si i tillë nxjerr urdhrin e prokurimit për vlerën limit të kontratës. Në këto kushte, ky organ përpara se të nxjerrë urdhrin e prokurimit duhet të ketë konfirmimin nga AK mbi vënien në dispozicion të fondeve buxhetore përpara se të marrë këtë angazhim.

OQB, duhet të vepronte sipas përcaktimeve të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime, Kapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika 140, ku cilësohet se “Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë”; dhe pika 142 “Nëpunësi zbatues bën krahasimin me nivelin e planifikuar të shpenzimeve për aktivitetin/nënprogramin/programin buxhetor respektiv, kryen gjithashtu kontrollin e përputhshmërisë ligjore dhe paraqet opinionin pranë nëpunësit autorizues. Opinioni mund të paraqitet me shkrim veçmas nga kërkesa për shpenzim, ose mund të nëshkruhet direkt nga nëpunësi zbatues në rast se është konform rregullave. Në rastin e marrjes së angazhimeve që shoqërohen me nënshkrim kontrate për blerje dhe shërbime, nëpunësi zbatues procedon me dhënien e opinionit pas kontrollit të njoftimit përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit dhe shpalljen në buletin e prokurimeve publike”. Në çdo rast nga OQB nuk ka gjurmë të një verifikimi të tillë mbi angazhimin e fondeve buxhetore.

Konkluzione nga auditimi:

1. Nga auditimi i fondeve të programuara konstatohet se nuk ka asnjë konfirmim mbi fondet buxhetore të vëna në dispozicion të AK, për marrjen përsipër të angazhimeve buxhetore. OQB i cili në këtë rast është autorizuar nga AK për kryerjen e procedurave të prokurimit, ka rolin e organit prokurues (zbatues) dhe si i tillë nxjerr urdhrin e prokurimit për vlerën limit të kontratës. Në këto kushte, ky organ përpara se të nxjerrë urdhrin e prokurimit duhet të ketë konfirmimin nga AK mbi vënien në dispozicion të fondeve buxhetore përpara se të marrë këtë angazhim.

3. Mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës limit të kontratës.

(Burimi i të dhënave për auditimin e kësaj pike të programit është marrë nga Sistemi i Prokurimeve Elektronike në faqen zyrtare të APP-së si dhe nga dosjet fizike të procedurës së prokurimit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme).

Baza ligjore në auditim.

-Ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,
-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,
-VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

-VKM nr. 28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë" me ndryshime,

-Të gjitha aktet e tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e subjektit.

Për shkak të volumit të dosjeve të tenderave u përzgjedh metoda me zgjedhje rastësore, metoda e gjurmimit të dokumentacionit. Çdo paqartësi që doli nga procesi i auditimit është diskutuar me personat kompetent që kanë ndjekur procesin e prokurimit të audituar.

DPP në cilësinë e OQB, mbi bazën e kërkesave të ardhura nga Autoritet Kontraktore për vitin 2016, ka nxjerrë urdhër prokurimin për fillimin e 44 procedurave të prokurimit ndarë në 149 lote gjithsej, me fond limit sipas loteve në total në vlerën 5,283,402,179 lekë pa TVSH dhe me vlerë të kontratave të prokuruar 4,032,226,727 lekë pa TVSH.

Bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, neni 11 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 2, specifikimet teknike dhe përllogaritja e vlerës së kontratave janë hartuar nga Autoritet Kontraktore dhe janë dërguar në OQB bashku me kërkesën për prokurim. OQB në zbatim të VKM nr.28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime" përpunon të dhënat sasiore si dhe ka llogaritur fondin limit si shumatoren e fondeve buxhetore, miratuar për çdo institucion sipas planit buxhetor. Ajo ka bashkërenduar punën për testimin e tregut për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen para publikimit të çdo procedure.

Fondi limit për çdo procedurë të përllogaritur nga OQB, rezulton i njëjtë në vlerë sa është edhe shumatorja e fondeve limite të ardhura nga AK. Në OQB nuk ka një informacion të detajuar se mbi cilën bazë është bërë llogaritja e fondit limit nga AK, si dhe një informacion mbi fondet buxhetore të miratuara bazuar në ligjin për buxhetin, pasi bashknëgjitur kërkesave për kryerjen e prokurimeve janë vetëm shkresat me specifikimet teknike dhe fondi limit në dispozicion por nuk ka informacion në lidhje me argumentimin e fondit limit. OQB ka bërë shumatoren e fondeve buxhetore që ka miratuar çdo institucion për secilin mall apo shërbim por nuk ka bërë verifikimin mbi angazhimin e fondeve buxhetore në planet vjetore të miratuara të buxhetit të cdo Autoriteti Kontraktor, kjo për shkak të mungesës së informacionit të dërguar nga AK si dhe mos bashkëpunimit të OQB me AK në këtë aspekt. Për vitin 2016, nga kryerja e procedurave të prokurimit të përqendruar, kemi një kursim në total 497,079,003 lekë ose 12%.

Mangësitë e konstatuara nga auditimi me zgjedhje:

I-Në procedurën e prokurimit me objekt "**Blerje automjete**", nga AK janë paraqitur specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës për blerjen e automjeteve, të cilat janë bërë pjesë e Dokumenteve të Procedurës së Prokurimit (DPP), pa asnjë ndryshim nga NJHD.

-Në përcaktimin e fondit limit DPP është mbështetur në fondin limit të përllogaritur nga secili AK dhe të përcjellë me shkresat përkatëse, në zbatim të VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 2, ku cilësohet: "*Ministria e Punëve të Brendshme të prokurojnë fondin limit, të llogaritur si **shumën e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi***".

-Nga auditimi ka rezultuar se disa AK, i kanë paraqitur me vonesë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin përkatës (sipas tabelës së mëposhtme), në tejkalim të afatit të përcaktuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3 ku cilësohet: "*Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, **brenda datës 31 janar**, të dërgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës, për çdo prokurim*".

Nr	Autoriteti Kontraktor	Shkresa nr/datë
1	Instituti I Mjekësisë Ligjore	Nr. 299, datë 08.02.2016



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

2	Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	Nr. 197, datë 01.02.2016
3	Shërbimi Informativ Shqiptar	Nr. 224, datë 02.02.2016
4	Garda e Republikës	Nr. 105, datë 21.01.2016
5	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Nr. 49, datë 19.01.2016
6	Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit	Nr. 271, datë 05.02.2016
7	ALUIZNI	Nr. 247, datë 03.02.2016
8	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Nr. 323, datë 11.02.2016
9	Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave	Nr. 260, datë 04.02.2016

II-Në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim katering II”, nga AK janë paraqitur specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës, të cilat janë bërë pjesë e DT, pa asnjë ndryshim nga NJHD.

-Përcaktimi i fondit limit nga OQB është bërë bazuar në neni 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe në vlerën limit të kontratës të përlogaritur nga secili AK dhe të përcjellë me shkresat përkatëse, në zbatim të VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 2, ku cilësohet “*Ministria e Punëve të Brendshme të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumën e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi*”.

-Nga auditimi ka rezultuar se disa AK, i kanë paraqitur më vonesë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin përkatës (sipas tabelës së mëposhtme), në tejkalim të afatit të përcaktuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3 ku cilësohet “*Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës, për çdo prokurim*”.

Nr	Autoriteti Kontraktor	Shkresa nr/datë	AK	AK	DPP	DPP
1	Njësia e Invizshme e kufirit Vlorë	335, datë 10.02.2016 543, datë 27.04.2016	18,265,632	01.07.2016 31.12.2019	15,754,932	01.01.2017 31.12.2019
2	Insituti shëndetësor i të burgosurve	518, datë 15.04.2016			65,177,265	87 ditë + 3 vjet
3	Akademia e sigurisë	371, datë 26.02.2016 501/5, datë 19.04.2016	127,980,593	01.07.2016 31.12.2018	124,831,821	01.10.2016 31.12.2018
4	Komisariati i Policisë NSH Fier	501/3, datë 15.04.2016	20,020,958	01.07.2016 31.12.2017	20,107,271	01.10.2016 31.12.2018
5	Reparti 4001, Korçë	2603/5, datë 25.03.2016 501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	4,501,007	15.11.2016 31.12.2019	4,501,007	15.11.2016 31.12.2019
6	Reparti 4001, Gjirokastrë	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	4,456,211	15.11.2016 31.12.2019	4,456,211	15.11.2016 31.12.2019
7	Reparti 4001, Kukës	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	4,411,415	15.11.2016 31.12.2019	4,411,415	15.11.2016 31.12.2019
8	Reparti 4001, Burrel	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	4,280,041	15.11.2016 31.12.2019	4,280,041	15.11.2016 31.12.2019
9	Reparti 3001, 3002, 3003, 3008 Tiranë	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	15,092,592	15.11.2016 31.12.2019	15,092,592	15.11.2016 31.12.2019
10	Reparti 3004, 3005 Kuçovë	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	15,217,316	15.11.2016 31.12.2019	15,217,316	15.11.2016 31.12.2019
11	Reparti 3006, Farkë	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	46,201,322	15.11.2016 31.12.2019	46,201,322	15.11.2016 31.12.2019
12	Reparti 2001, 2002, 2006 Plepa Durrës	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	12,860,721	15.11.2016 31.12.2019	12,860,721	15.11.2016 31.12.2019
13	Reparti 2004, Kepi i Palit Durrës	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	45,961,643	15.11.2016 31.12.2019	45,961,643	15.11.2016 31.12.2019
14	Reparti 1010, Vau Dejës Shkodër	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	76,479,226	15.11.2016 31.12.2019	76,479,226	15.11.2016 31.12.2019
15	Reparti 6620, Sauk Tiranë	501/4, datë 15.04.2016 1102, datë 15.09.2016	40,506,932	15.11.2016 31.12.2019	40,506,932	15.11.2016 31.12.2019
	Totali Reparteve		269,968,424		269,968,424	15.11.2016 31.12.2019
	Totali i loteve				495,839,615	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

-Me shkresën nr. 501, datë 11.04.2016 nga DPP, është kërkuar rishikim i vlerës limit të kontratave nga AK, në përgjigje të saj AK kanë përlogaritur vlerën limit të kontratës sipas të dhënave të tabelës së mësipërme.

III. Në procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje mobilje dhe orendi zyre**”, nga AK janë paraqitur specifikimet teknike të cilat janë bërë pjesë e DT, pas unifikimit të tyre nga OQB. Përcaktimi i fondit limit nga OQB është bërë bazuar në neni 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Nr	Autoritetet Kontraktore	AK	OQB	Diferenca
1	Ministria e Financave	10,128,850	10,128,850	0
2	Garda e Republikës	2,362,385	2,362,375	-10
3	Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit	10,100,013	10,000,013	-100,000
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	1,665,250	1,665,250	0
5	Drejtoria e Policisë së Shtetit	12,509,611	10,424,813	-2,084,798
6	Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Zhvillimit të Territorit	2,480,425	2,480,425	0
7	Ministria e Zhvillimit Urban, Arkivi Qendror Teknik	2,480,425	2,480,425	0
8	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	17,131,088	17,131,088	0
9	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	5,000,000	5,000,101	101
10	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	1,631,774	1,359,811	-271,963
11	Ministria e Punëve të Brendshme	65,080,658	65,080,658	0
	Totali	130,570,479	128,113,809	2,456,670

Për përcaktimin e fondit limit, sipas urdhrit nr. 1493, datë 09.12.2015 të Titullarit të OQB, është ngritur grupi i punës i përbërë nga A.H dhe E.S. për testimin e tregut për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh”. Me shkresën nr. 1793/1, datë 05.01.2016 grupi i punës ka përcjellë informacionin për Titullarin e OQB, mbi dërgimin e ftesës për ofertë 4 OE. Operatorët kanë dërguar ofertat e tyre së bashku me specifikimet teknike për artikujt përkatës. Nga grupi i punës janë përlogaritur çmimet/njësi, si mesatare e çmimit për çdo artikull. Po ti referohemi datave të paraqitjes së kërkesave nga AK, mbi llojin e artikujve, specifikimet teknike dhe fondin limit të tyre, ato në zbatim të VKM-së nr. 28, datë 14.01.2015 kanë afatin e dorëzimit të tyre deri më datë 31.01.2016. Gjithashtu, një pjesë e tyre i kanë sjellë me vonesë kërkesat e tyre, përtej këtij afati. Për rrjedhojë dalja e këtij urdhri dhe testimi mbi çmimet e artikujve paraprakisht pa patur dijeni mbi kërkesat e AK, mbi llojin e artikujve që kërkon, specifikimet teknike etj, si dhe dërgimi për referencën AK, është në tejkalim të kompetencave që aktet ligjore dhe nënligjore i kanë dhënë OQB.

Nga OQB, është vepruar në kundërshtim me:

-VKM nr.914, datë 29.12.2014, neni 2, pika 5 ku cilësohet “...Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse organi qendror blerës vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPP ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor. Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me ekspertë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet”. **Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore kanë marrë për bazë çmime të ndryshme për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përlogarit të dhënave sasiore, sipas fondit përkatës.**

-VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pikanë 2, 3 dhe 4, ku cilësohet:

“2. Ministria e Punëve të Brendshme të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumën e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

“3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dnrgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës, për çdo prokurim”;

“4 germa (dh), ku cilësohet: **“të bashkërendojnë punën për testimin e tregut, për përlllogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit.** Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra”, si dhe me udhëzimin nr. 1, datë 27.01.2015 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, nga organi qendror blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, për disa mallra dhe shërbime, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, pika 2, 3 dhe 4 ku cilësohet radha e veprimeve si më poshtë vijon:

“2. Autoritetet kontraktore dnrgojnë pranë Organit Qendror Blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, me anë të një kërkesë të veçantë të bërë në formë shkresore dhe elektronike, nevojat për mallrat dhe shërbimet e sipërpermendura, ku përcaktohen specifikimet teknike, sasitë e mallrave ose shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe vlerën e përlllogaritur (pa TVSH).

3. Organi Qendror Blerës, Ministria e Punëve të Brendshme bashkëpunon me autoritetet kontraktore për të mbledhur të dhënat për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen, duke koordinuar punën për testimin e tregut me qëllim përlllogaritjen e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen para publikimit të njoftimit të kontratës. Organi Qendror Blerës verifikon përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me dispozitat ligjore dhe standartet teknike në fuqi.

4. Organi Qendror Blerës, Ministria e Punëve të Brendshme shqyrton specifikimet teknike të dërguara nga autoritetet kontraktore”.

- Nga auditimi ka rezultuar se disa AK, i kanë paraqitur më vonesë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin përkatës (sipas tabelës së mëposhtme), në tejkallim të afatit të përcaktuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3.

Nr	Autoriteti Kontraktor	Shkresa nr/datë
1	Ministria e Punëve të Brendshme	Nr. 398, datë 21.03.2016
2	Drejtoria e Policisë së Shtetit, FNSH	Nr. 140, datë 25.01.2016
3	Ministria e Financave	Nr. 85, datë 21.01.2016
4	Garda e Republikës	Nr.105, datë 21.01.2016
5	Drejtoria e Policisë së Shtetit, DPKM	Nr. 169, datë 28.01.2016
6	MZHE, T	Nr. 150, datë 27.01.2016
7	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Nr. 51, datë 19.01.2016
8	Arkivi Qendror Teknik	Nr. 199/1, datë 01.02.2016
9	Agjencia e Zvillimit të Territorit	Nr. 181, datë 01.02.2016
10	DPT	Nr. 408, datë 07.03.2016
11	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Nr. 328, datë 12.02.2016

Konkluzione nga auditimi:

1.DPP duke qënë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nxjerr Urdhër Prokurimin për kryerjen e procedurave të tenderit i cili përmban ndër të tjera sipas nenit 60 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, dhe fondin limit. Në llogaritjen e fondit limit konstatohet se nga DPP nuk bëhen verifikimet e domosdoshme mbi angazhimin e fondeve buxhetore në planet vjetore të miratuara të buxhetit të cdo Autoriteti Kontraktor, kjo për shkak të mungesës së informacionit të dërguar nga AK si dhe mos bashkëpunimit të OQB me AK në këtë aspekt.

2. Disa AK, i kanë paraqitur me vonesë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin përkatës në tejkallim të afatit të përcaktuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3.

4.Hartimi i dokumenteve të tenderit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

(Burimi i të dhënave për auditimin e kësaj pike të programit është marrë nga Sistemi i Prokurimeve Elektronike në faqen zyrtare të APP-së si dhe nga dosjet fizike të procedurës së prokurimit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme).

Baza ligjore në auditim.

- Ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,
- Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, l-
- Ligji nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”
- VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”,
- VKM nr.28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë” me ndryshime,
- Të gjitha aktet e tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e subjektit.

Për **vitin 2016**, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, në Ministrinë e Punëve të Brendshme në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar në cilësinë e Organit Qendror Blerës (OQB), si dhe në zbatim të VKM nr.28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ka zhvilluar procedura prokurimi për llogari të Autoriteteve Kontraktore të njohura me ligj. Me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe uljen e kostos administrative të autoriteteve kontraktore, kjo Drejtoria ka ndjekur rregullin e ndarjes në lote të kontratës për disa blerje/shërbime homogjene apo të ngjashme, bazuar në nenin 9, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

Nga auditimi me zgjedhje, i hartimit të dokumentacionit të tenderit konstatohet si mangësi e përgjithshme se:

-Për **vitin 2016**, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, në cilësinë e OQB bazuar në VKM-së nr. 28, datë 14.01.2015, me ndryshime, pika 4 dhe Udhëzimin e APP nr.1, datë 27.1.2015, pika 2, bën mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike dërguar nga AK, ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave që prokurohen si dhe vlerën e përllogaritur të fondit limit. Bazuar në nenin 60 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, nxjerr urdhër prokurimin i cili përmban dhe vlerën e fondit limit. Për të konfirmuar nëse Autoritet Kontraktore kanë të angazhuar fondet në planet e tyre buxhetore, DPP nuk bën asnjë verifikim, minimumi të kërkojë nga këto autoritete shkresat zyrtare të çeljes së fondeve në dispozicion të tyre, pasi duke qënë në cilësinë e një Autoriteti Kontraktor tashmë ajo ka përgjegjësinë dhe detyrimin që rrjedh nga neni 60 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime sipas të cilit, “*me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas llogaritjes së fondit limitnxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.... i cili duhet të përmbajëfondin e përllogaritur të vitit ushtrimor...*”. Në këtë këndvështrim, DPP në nxjerrjen e fondit limit mjaftohet vetëm me vlerën e fondit limit të dërguar nga Autoritet Kontraktore i cili në shumicën e rasteve nuk ka bashkangjitur shkresat për llogaritjen e tij, duke mos identifikuar/verifikuar angazhimin e fondeve buxhetore të miratuara në dispozicion të Autoriteteve Kontraktore.

-OQB, nuk disponon një regjistër të të dhënave, i cili të përmbajë të dhënat mbi fondin limit sipas loteve, fondin limit të prokuruar, operatorin ekonomik fitues etj. që të publikohet në faqen zyrtare



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

të APP-së, për të mundësuar lehtësisht verifikimin e tyre, mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe fondeve në dispozicion. Ky fakt është konstatuar dhe nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, por nga ana DPP nuk është zbatuar rekomandimi i saj për përmirësimin e gjendjes.

Nisur nga mangësitë specifike të dala nga auditimi, më poshtë i trajtojmë ato sipas procedurave:

I-Në procedurën e prokurimit “**Blerje automjete**”, ndarë në 11 lote me kufi monetar në total 64,066,666 lekë pa TVSH vënë dispozicion nga buxheti i shtetit dhe vlerë kontrate e prokuruar gjithsej 61,988,583 lekë pa TVSH, janë miratuar dokumentet e tenderit për të gjitha lotet nga Njësia e Prokurimit me procesverbalin nr.ska, datë ska.

Nga auditimi i dokumentacionit të tenderit për 11 lote konstatohet se:

-Në hartimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit “Kapaciteti Teknik”, pika 3, vihet re që afati për garancinë e mallit ndryshon nga loti në lot, i cili varion nga një vit në tre vite. Vendosja e këtij kriteri variabël, nuk krijon kushte për stimulimin e operatorëve ekonomikë dhe nuk nxit dhe nuk inkurajon pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në përputhje me nenin 46/3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime.

-Konkretisht për lotet IV, V dhe VI, në pikën 2 germa (ç) është përcaktuar kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë “Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 **(në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)**”. Në përcaktimin e DT, mbështetur në DST “Për mallrat” NJHD duhet t’i hartojë ato dhe të vendosë kërkesa në përputhje me llojin e prokurimit dhe kontratës. Sa më sipër NJHD, nuk duhet të përcaktojë në DT, Kërkesa të cilat nuk kanë të bëjnë me procedurën konkrete.

Në mënyrë grafike të dhënat variabile jepen në tabelën nr.1:

Tabela nr.1

LOTI	Procedura e prokurimit “Blerje automjete”	Afati garancisë së mallit
II	Blerje automjeti për D S I K	2 vjet
IV	Blerje automjete për Garden e Republikës	2 vjet
V	Blerje fuoristrade për Garden e Republikës	2 vjet
VI	Blerje Mikrobuz Min 11+1 për Garden e Republikës	2 vjet
VIII	Blerje fuoristrade për Sekretariatit Teknik te Keshillit Kombetar te Ujit	2 vjet
IX	Blerje automjete për ALUIZNI	2 vjet
I	Blerje Mikrobuz Min 8+1 per Institutin e Mjekesise Ligjore	3 vjet
VII	Blerje fuoristrada për Agjencine Kombetare te Bregdetit	3 vjet
X	Blerje fuoristrade për AKSHI	3 vjet
XI	Blerje mjet vinç, pirun me motorr për DPRMSH	1 vit

-Në shtojcën 4, (DT) të miratuar nga Autoriteti Kontraktor (OQB), nuk është kërkuar sigurimi i ofertës, por këtyre dokumenteve i është bashkangjitur shtojca 3, si pjesë e dokumenteve të tenderit e cila është e panevojshme dhe nuk duhet të jetë pjesë përbërëse e tyre, pasi vështirëson punën e operatorëve ekonomikë në plotësimin e dokumentacionit të tenderit.

Konkretisht për lotet IV, V dhe VI, në pikën 2/a “Kriteret e veçanta të kualifikimit” ka përcaktuar si kërkesë “Sigurimin e ofertës (nëse është e zbatueshme), sipas shtojcës 4”. Në DT, duhet të përcaktohet në mënyrë taksative kjo kërkesë sipas gjykimit të NJHD. Fakti “nëse është e zbatueshme apo jo” duhet dhe është e AK dhe jo e operatorëve ekonomikë.

-Gjithashtu në pikën 2/ç është përcaktuar kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: “Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 **(në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)**”. Në përcaktimin e DT, mbështetur në DST “Për mallrat” NJHD duhet t’i hartojë ato dhe të vendosë kërkesa në përputhje me llojin e prokurimit dhe kontratës. Sa më sipër NJHD, nuk duhet të përcaktojë në DT, kërkesa të cilat nuk kanë të bëjnë me procedurën konkrete. Nga DPP, mund të bëhej unifikimi i kësaj kërkesë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

mbështetur në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 4/d, ku cilësohet “Organi qendror blerës ka detyrë dhe përgjegjësi të unifikojnë specifikimet teknike, për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse, ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni **autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra**”.

-Për lotin IV, sipas DT, subjekti “...” ka paraqitur autorizim prodhuesi, ku afati i marrëveshjes së lidhur prodhuesin mban datën 27.11.2006 dhe në kapitullin XII “Kushtet dhe zgjidhja e marrëveshjes” cilësohet: “

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga Palet në Marrëveshje dhe zgjidhet për një periudhë kohore të pacaktuar.

Sa më sipër, pavarësisht paraqitjes së marrëveshjes, AK nuk mund të dijë nëse kjo marrëveshje me prodhuesin është efektive në momentin e zhvillimit të procedurës së konkurrimit apo jo. Nisur nga kjo në DT, duhej të kërkohej edhe deklaratë me shkrim nga prodhuesi dhe së paku nga operatori ekonomik, ku të shprehen se marrëveshja në fjalë është në fuqi.

-DT për Lotin VII “**Blerje fuoristrada për AKB**”, në specifikimet teknike, shtojca 10, kërkohet që “ngjyra” të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës. Vendosja e këtij kriteri, është në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, pasi specifikimet teknike duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të përshkruajnë sa më saktë dhe në mënyrë sa më të plotë objektin e prokurimit, me qëllim që të krijohen kushte për një konkurim të paanshmë e të hapur ndërmjet ofertuesve duke dhënë një ide të qartë në përgatitjen e ofertës.

II-Në procedurën e prokurimit “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)”, ndarë në 31 lote me kufi monetar në total 1,822,592,504 lekë pa TVSH vënë dispozicion nga buxheti i shtetit dhe vlerë kontrate e prokuruar gjithsej 1,472,073,789 lekë pa TVSH, janë miratuar dokumentet e tenderit për të gjitha lotet nga Njësia e Prokurimit me procesverbalin datë 29.4.2016.

Nga auditimi i dokumentacionit të tenderit për 31 lote konstatohet se:

-Në Urdhër Prokurimin nr.15, datë 27.4.2016, fondi limit rezulton të jetë në vlerën 1,822,592,504 lekë pa TVSH, por nga shumatorja e fondeve limit sipas loteve, del vlera 1,950,573,097 lekë pa TVSH, e cila nuk është korrigjuar nga Njësia e Prokurimit.

-Në kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti teknik”, pika 11, për personelin e kuzhinës dhe konkretisht për punonjësit me profesione: kuzhinier, mercolog/kimist/teknolog, ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, nuk është kërkuar që të paraqesin edhe librezën shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, sipas nenit 21 të ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror” me ndryshime. Mungesa e një kriteri të tillë përbën burim rreziku për përhapjen e sëmundjeve ngjyese në procesin e përgatitjes së ushqimit që është object i tenderimit.

-Në kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti teknik”, për lotet V, VII,XI, XII,XII, XIV, nuk është kërkuar certifikatë ISO 14001:2004 dhe certifikatë ISO 18001:2007 për cilësinë e menaxhimit të sigurisë. Referuar nenit 46 të LPP dhe nenit 27/6,c dhe nenit 30/2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” me ndryshime, certifikatat e kërkuara (që vërtetojnë se punët/mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë) duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit të ofertuesve.

-Në kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti teknik”, nuk është kërkuar si kriter paraqitja e kontratës për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm lidhur me OSHEE dhe Ujësjellës Kanalizime (UK), nga operatori ekonomik, për vërtetimin e disponimit të pandërprerë të punës në ambientin ku do të ushtrojnë veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

-Formulari "Kapaciteti teknik", pika 2.3, nuk ka të përcaktuar si klauzolë dokumentet (kontratën e qirasë mes operatorit ekonomik fitues dhe AK) që duhet të paraqesë operatori ekonomik në rastet kur Autoriteti Kontraktor kërkon që gatimi, përgatitja, shpërndarja dhe servirja e ushqimeve do të bëhet detyrimisht në ambientet (kuzhinën/mensën e repartit) e tij të cilat janë detyruese për lotet II, III, XVII XXIVetj. Vendosja e një kriteri të tillë është e detyrueshme pasi lidhet me kërkesat e paraqitura nga Autoritet Kontraktore, sidomos nga reparte ushtarake

-DT, kriteret e veçanta të kualifikimit "Kapaciteti teknik", pika 12, në disa lote ndryshojnë dhe pse objecti i tendrimi është i njëjtë, si në Lotet: VI, XVII, XXVI, etj. ku kërkohej që "punonjësit të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve të kërkuara në tabelën e mëposhtme: ... Mercollog/kimist/teknolog", ndërkohë që në lotet XXV, XXVII etj. profesionet e kërkuara janë "... Mercollog/kimist". Vendosja e kriterëve minimale të cilat ndryshojnë nga njëri lot në tjetrin dhe pse objecti i prokurimit është i njëjtë, nuk inkurajon pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në konkurim. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të plotësojnë kërkesat minimale dhe stimulojnë pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 2, pika c dhe ç, neni 20, 46 si dhe me VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 27/3.

III-Në procedurën e prokurimit "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering II)", ndarë në 15 lote me kufi monetar në total 495,839,715 lekë pa TVSH vënë dispozicion nga buxheti i shtetit janë miratuar dokumentet e tenderit për të gjitha lotet nga Njësia e Prokurimit me procesverbalin datë 22.09.2016.

Nga auditimi i dokumentacionit të tenderit për 15 lote konstatohet se:

-Në DT, pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" germa (a) është përcaktuar si kërkesë: "Sigurimin e ofertës (nëse është e zbatueshme), sipas shtojcës 4". Në DT, duhet të përcaktohet në mënyrë taksative kjo kërkesë, ose të kërkohej siguri sipas 4 ku të përcaktohet vlera dhe afati, ose të mos kërkohej, kjo sipas gjykimit të NJHD. Faktin "nëse është e zbatueshme apo jo" duhet dhe është detyrë e AK dhe jo e operatorëve ekonomikë.

-Gjithashtu, në pikën 2 germa (ç) është përcaktuar /ofertuesi duhet të dorëzojë "Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 **(në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)**". Në përcaktimin e DT, mbështetur në DST "Për mallrat" NJHD duhet t'i hartojë ato dhe të vendosë kërkesa në përputhje me llojin e prokurimit dhe kontratës. Sa më sipër NJHD, nuk duhet të përcaktojë në DT, Kërkesa të cilat nuk kanë të bëjnë me procedurën konkrete.

-Nga KVO, për Lotin IV, është argumentuar se OE "... midis të tjerave nuk ka plotësuar pikën 1/d tek "Kriteret e veçanta për kualifikim" të shtojcës 7 të DT, pasi vërtetimi i debisë lëshuar nga OSSHE nuk përfshin faturën e muajit shtator, gjë e cila nuk është e përcaktuar në DT si afat. Nga NJHD, në DT duhej të përcaktohej, në raport me datën e hapjes së procedurës së prokurimit, afati i pagesës së energjisë nga OE.

Mangësitë e konstatuara sipas loteve:

Në lotin I, në shtojcën 9 "Specifikimet teknike" është kërkuar:

Racionet ushqimore në total sipas normës;

Përbërja e sipas normës, sipas artikujve ushqimore dhe k/kal;

Kërkesa të domosdoshme për realizimin e shërbimit katering, **kushtet;**

Kërkesa për gatimin dhe përgatitjen e ushqimit;

Programin ushqimor.

Në lotin II, në shtojcën 9 "Specifikimet teknike" është kërkuar:

- Racionet ushqimore në total sipas normës;

- Përbërja e sipas normës, sipas artikujve ushqimore dhe k/kal;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Në lotin III, në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” është kërkuar:

- Racionet ushqimore ne total sipas normës;
 - Përbërja e sipas normës, sipas artikujve ushqimore dhe k/kal;
- Specifikimet teknike të lëndëve të para që do të përdoren për gatim dhe ushqim.

- Programin ushqimor.
- Servirja e ushqimit
- Kërkesa higjeno-sanitare

Në lotin IV, në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” është kërkuar:

- Racionet ushqimore ne total sipas normës;
 - Përbërja e sipas normës, sipas artikujve ushqimore dhe k/kal;
- Specifikimet teknike të lëndëve të para që do të përdoren për gatim dhe ushqim.

- Kushtet;
- Kërkesa për gatimin dhe përgatitjen e ushqimit;
- Programin ushqimor;
- Servirja e ushqimit;
- Kërkesa higjeno-sanitare;
- Kërkesa për organizimin dhe menaxhimin e ushqimit;
- Ambientet dhe vendet e punës;
- Personeli;
- Shërbimet dhe grafiku i Invrimit;
- Termat e referencës;
- Inventari ekonomik.

Lotet V-XV, Repartet Ushtarke.

- Racionet ushqimore ne total sipas normës;
- Përbërja e sipas normës, sipas artikujve ushqimore dhe k/kal;
- Specifikimet teknike mbi artikujt ushqimore që do të përdoren për gatim dhe ushqim.
- Të dhëna mbi artikujt ushqimore si: *pamja e jashtme, ngjyra; era dhe shija; treguesit fiziko-; amballazhimi dhe marketimi.*

Nga DPP, mund të bëhej unifikimi i kësaj kërkesë mbështetur në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 4/d, ku cilësohet “*Organi qendror blerës ka detyrë dhe përgjegjësi të unifikojnë specifikimet teknike, për mallra dhe shërbime të të njëjtët lloj, ... Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra*”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me cilësinë ushqimore dhe kërkesat mbi to mund të unifikoheshin, konkretisht, cilësia dhe përbërjet fiziko-kimike të artikujve duhej të ishin të njëjta për të gjitha procedurat e konkurimit.

-Gjithashtu nga NJHD, nuk është unifikuar lloji i kërkesave në DT. Konkretisht, në Lotin I nuk është, pjesa e Specifikimeve teknike mbi artikujt ushqimore, në Lotin II nuk është kërkuar dhe nuk është pjesë e DT, shtojca nr. 9, janë vetëm të dhëna të cilat janë edhe pjesë e “Formularit të ofertës” sipas shtojcës 1.

-Ka rezultuar se nga NJHD, nuk janë pasqyruar në DT, specifikimet sipas kërkesave të AK. Në lotet V-XV, specifikimet teknike të paraqitura nga Forcat e Armatosura për Repartet Ushtarake, **nuk janë të gjitha të përfshira në DT.**

Forcat e Armatosura, kanë paraqitur në OQB kërkesën për prokurim, për periudhën 15.11.2016-31.12.2019. Nga AK “Forcat e Armatosura, Komanda Mbështetëse”, janë dërguar:

Referenca ligjore e nënligjore;

Baza ligjore për hartimin e dokumentacionit të kërkesave;

Përcaktimi i fondit limit;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Grafiku i Invrimit, pjesë e DT shtojca 11.

Specifikimet teknike

-Në hartimin e DT nga NJHD/OQB është përcaktuar fondi limit sipas kërkesës së paraqitur nga AK, referuar sasisë së kalorive, sasisë së vakteve, totalit të racioneve, çmimit për racion (referuar normës).

-Në dokumentacionin e paraqitur nga AK “Kushtete teknike”, pika 3 është kërkuar: “OE të bnjë shpërndarjen e ushqimit të gatuar, sipas orarit që do të përcaktohet në shtojcën **“Termt e referencës”** për tre vaktet e ngrnëies së ushqimit në vendin e përcaktuar brenda repartit bazë të planit të përhapjes së miratuar”. Në DT, **nuk ka të përcaktuara “Terma reference”**, ku të jenë të cilësuar këto Kërkesa të AK.

-Në kapitullin “Programi ushqimor” pika 2 “Servirja e ushqimit” është kërkuar “Shpërndarja e ushqimit do të bëhet nga OE me pajisjet e tij në mensat e AK. Plotësimi i kësaj kërkesë kërkon që **OE të ketë kontratë me AK**, si dhe ambjenti të plotësojë të gjitha kërkesat dhe kushtet higjeno sanitare. Në DT, është cilësuar një kërkesë e tillë vetëm për ambjentin e kuzhinës. Ndërkohë që sipas kërkesës së AK, ushqimi duhet të serviret në ambientet e AK, gjë e cila kërkon plotësimin e kushteve higjeno-sanitare. Në kërkesat e Akademisë së Sigurisë, Loti III dhe Njësia e lëvizshme e kufirit Vlorë, Loti I, është kërkuar gjithashtu që shërbimi të bëhet në ambiente të AK, gjë për të cilën duhet të lidhë kontratë qiraje me AK.

-Po kështu nga AK në Lotin III, është kërkuar që OE të disponojë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit për rreth 500 vetë në çdo vakt (me dokument);

-Në pikën 7 “Struktura organizative e personelit të shërbimit dhe ushqimit është kërkuar: “Administrator, përgjegjës shërbimi, K/kuzhinier, kuzhinier, nd/kuzhinier, Merceolog, mirëmbajtës dhe shofer”. Në DT, për RU në kërkesat për personel është cilësuar se OE, duhet të ketë 1 kuzhinier dhe 1 nd/kuzhinier, duke pasqyruar minimalisht kërkesat e OE.

-Në pikën 3 “Kërkesa higjeno-sanitare” si dhe në pikën 6 “Kërkesat për personelin kryesor”, është kërkuar “Personeli i kuzhinës dhe shpërndarjes së ushqimit duhet të jenë të pajisur me librezë përkatese shëndetësore nga Inspektoriati i higjenës”, kërkesë e cila nuk është specifikuar në DT. Sipas ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektoriatin sanitar shtetëror” neni 21, cilësohet: Organet e Inspektoratit Sanitar Shtetëror kanë për detyrë të pajisin me librezë shëndetësore gjithë personat që punojnë në objektet e prodhimit, të ruajtjes, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, në ujësjellës, në institucione parashkollore, shkollore e shëndetësore dhe në objektet e shërbimit publik, ku mund të lehtësohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse. Lista e profesioneve dhe kategoritë e punonjësve që pajisen me librezë shëndetësore, përcaktohen nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrotjes së Mjedisit.

-Gjithshtu është kërkuar që personeli të ketë uniformë dalluese, kërkesë që nuk është cilësuar në DT.

-Pjesë e dokumentacionit të AK janë edhe “Specifikimet teknike të artikujve ushqimore”, ku janë përcaktuar kërkesat që duhet të plotësohen për disa tregues të ushqimeve si: *Pamja e jashtme, ngjyra; Era dhe shija; Treguesit fiziko-kimikë; Amballazhimi, Markerimi*. Nga auditimi ka rezultuar se nuk janë përcaktuar specifikimet për artikujt ushqimore sipas AK.

-Sipas të dhënave nga DT, ka rezultuar se nga NJHD, numri i punonjësve nuk është përcaktuar sipas kërkesave të OE, por gjithashtu nuk është ndjekur standard i njëjtë për të gjitha lotet, ku të përcaktohej raporti një punonjës/për numrin e racioneve ushqimore, (si një raport i matshëm).


Lotet	Certifikata cilnsie	Numri i njësive që ju ofrohet shërbim	Numër racionesh	Numër punonjësish
I	5	Njësia e lëvizshme e kufirit Vlorë	26,370	4
II	5	Insituti shëndetsor i të burgosurve	118,200	8



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

III	5	Akademia e sigurisë	745.170	11
IV	5	Komisariati i Policisë NSH Fier	44,707	5
V	4	RU 4001 Korçë	8,900	2
VI	4	RU 4001 Gjirokastrë	8.780	2
VII	4	RU 4001 Kukës	8,660	2
VIII	4	RU 4001 Burrel	8.388	2
IX	5	RU 3001, 3002, 3003 dhe 3008 Rinas	24.201	4
X	5	RU 3004 dhe 3005 Kuçovë	23.132	4
XI	5	RU 3006 Farkë	84.700	8
XII	5	RU 2001, 2002 dhe 2006 Plepa-Durrës	19.308	3
XIII	5	RU 2004 Kepi Palit Durrës	86,935	6
XIV	5	RU 1010 Vau Dejës Shkodër	145,886	9
XV	5	RU 6620 Sauk Tiranë	78.510	7



-Në DT të hartuara nga Njësia rezultojnë se janë përcaktuar si pjesë të DT “Specifikimet teknike për mallrat ushqimore” dhe “Termat e referencës”, dhe kjo vjen në përputhje me nenin 11, pika 3/b ku cilësohet: “*Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën specifikimet teknike, etj*” dhe germa (c) ku cilësohet “*Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën termat e referencës, etj*”, por në DT këto kërkesa nuk kanë asnjë dallim, pra shtojca 9 “Specifikimet teknike” dhe Shtojca 11 “Termat e referencës” pasqyrojnë të njëjtat kërkesa. Nga OQB, duhej që të bëhej ndarja e tyre referuar kërkesave të AK dhe kuptimit që ato kanë.

-Nga NJHD gjatë kohës së auditimit nuk u vunë në dispozicion kërkesat e dërguara nga AK mbi fondin limit dhe specifikimet teknike për lotet I, II, III dhe IV, si dhe mbajtja e dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara në vitin 2016, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” me ndryshime, pasi ato nuk janë inventarizuar dhe nuk janë dorëzuar në protokoll-arkivë.

Sa më sipër mban përgjegjësi NJHD.

IV- Në procedurën e prokurimit “**Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash**”, me fond limit 43,794,015 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të prokuruar gjithsej 42,309,380.00 lekë pa TVSH, Njësia e Prokurimit ka miratuar dokumentet e tenderit me procesverbalin nr. s’ka , datë s’ka. Nga auditimi i DT konstatohet se:

-Në “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3/2 është kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim “për numrin e punëtorëve jo më pak se 25,... nga të cilët të paktën 1 punonjës të jetë inxhinier druri”. Një kërkesë e tillë tejkalon objektin e kontratës e cila është “kontratë blerje” dhe jo “kontratë shërbimi”. Kërkesa për inxhinier druri do të ishte e domosdoshme dhe minimale nëse kemi të bëjmë me porositjen për prodhim të pajisjeve për mobilim zyrash dhe jo në rastin e kontratës së blerjes së këtyre pajisjeve. AK nuk duhet që në kërkesat e vecanta për kualifikim, të përfshijë kriteret të cilat nuk janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës, por duhet të kërkojë që ata të plotësojnë kërkesat minimale. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

-Nga AK është kërkuar si kriter i vecantë kualifikimi pika 2.3/3,4,5,6 paraqitja e certifikatave ISO (9001-2008, 4001-2004, 3834-2005) dhe OHSAS 18001-2007. Referuar objektit të kontratës që “blerje” dhe jo “shërbim” vendosja e këtyre kriterëve bie në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, pasi është e tepërt dhe tejkalon objektin e kontratës. Certifikatat kanë të bëjnë jo me cilësinë e produktit por me cilësinë e menaxhimit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet evropiane, të cilat kërkohen në rastin e kontratave të shërbimit.

-Kërkesë tjetër e vecantë kualifikimi kërkuar nga AK është dhe pajisja me “leje mjedisore”, pika 10 e kërkesës për kapacitet teknik (2.3).Vendosja e këtij kriteri përbën tejkalim të objektit të kontratës, pasi procedura e prokurimit ka për object “blerje malli” dhe jo “shërbim”, interpretimi ligjor i të cilit është trajtuar më sipër.

Për sa sipër konstatuar është detyrë dhe përgjegjësi e Njesisë së Prokurimit që bazuar në VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 57, të përgatisë dokumentet e tenderit duke përcaktuar qartë kriteret, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik, në mënyrë që të mos ketë asnjë ekuivok në përgatitjen e ofertës nga operatorët ekonomikë.

V-Në procedurën e prokurimit “Blerje orendi dhe pajisje zyrash” me fond limit 128,113,807 lekë (pa TVSH), Njësia e Hartimit të Dokumenteve (NJHD), bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime Kreu V, neni 57 dhe neni 61, ka mbajtur procesverbalin datë 22.09.2016, për hartimin e DT.

Në DT, në pikën 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” germa (a) ka përcaktuar si kërkesë: “Sigurimin e ofertës (nëse është e zbatueshme), sipas shtojcës 4”. Në DT nga NJHD, duhet të përcaktohet në mënyrë taksative kjo kërkesë, ose të kërkohet sigurimi sipas 4 ku të përcaktohet vlera dhe afati, ose të mos kërkohet, kjo sipas gjykimit të NJHD. Faktin “nëse është e zbatueshme apo jo” duhet dhe është detyrë e AK dhe jo e operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, në pikën 2 germa (ç) është përcaktuar /ofertuesi duhet të dorëzojë “Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)”. Në përcaktimin e DT, mbështetur në DST “Për mallrat” NJHD duhet t’i hartojë ato dhe të vendosë kërkesa në përputhje me llojin e prokurimit dhe kontratës.

-Pjesë e DT është edhe shtojcat mbi marrëveshjen kuadër, ku nuk është e nevojshme pasi në UP është përcaktuar forma e prokurimit që është “tender i hapur”.

Mbi kërkesat e DT.

-Në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3/2 është kërkuar nga operatorët ekonomikë paraqesin vërtetim “për numrin e punëtorëve jo më pak se 40, ... nga të cilët të paktën 1 punonjës të jetë inxhinier druri”. Një kërkesë e tillë tejkalon objektin e kontratës e cila është “kontratë blerje” dhe jo “kontratë shërbimi”. Kërkesa për inxhinier druri do të ishte e domosdoshme dhe minimale nëse kemi të bëjmë me porositjen për prodhim të pajisjeve për mobilim zyrash dhe jo në rastin e kontratës së blerjes së këtyre pajisjeve. AK nuk duhet që në kërkesat e veçanta për kualifikim, të përfshijë kriteret të cilat nuk janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës, por duhet të kërkojë që ata të plotësojnë kërkesat minimale. Një veprim i tillë është në kundërshtim me seksionin II “Informacione të veçanta për kontratat” nenin 27/3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

-Nga AK është kërkuar si kriter i vecantë kualifikimi pika 2.3/3, 4, 5, 6 paraqitja e certifikatave ISO (9001:2008, 14001:2004, 3834:2005 dhe 18001:2007). Referuar objektit të kontratës që është “blerje” dhe jo “shërbim”, vendosja e këtyre kriterëve bie në kundërshtim me nenin 27.3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, pasi nuk është në koherencë me objektin e kontratës. Certifikatat kanë të bëjnë jo me cilësinë e produktit por me cilësinë e menaxhimit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet evropiane të cilat kërkohen në rastin e kontratave të shërbimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

-Kërkesë tjetër e vecantë kualifikimi kërkuar nga AK është dhe pajisja me “leje mjedisore/autorizim mjedisor”, pika 10 e kërkesës për kapacitet teknik (2.3). Vendosja e këtij kriteri përbën tejkalim të objektit të kontratës, pasi procedura e prokurimit ka për objekt “blerje malli” dhe jo “shërbim”.

Konkluzione nga auditimi:

1. Për vitin 2016, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, në cilësinë e organit qendror blerës (OQB) bazuar në VKM-së nr. 28, datë 14.01.2015, me ndryshime, pika 4 dhe Udhëzimin e APP nr.1, datë 27.1.2015, pika 2, bën mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike dërguar nga AK, ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave që prokurohen si dhe vlerën e përllogaritur të fondit limit Bazuar në nenin 60 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, nxjerr urdhë prokurimin i cili përmban dhe vlerën e fondit limit. Për të konfirmuar nëse Autoritet Kontraktore kanë të angazhuar fondet në planet e tyre buxhetore, DPP nuk bën asnjë verifikim, minimumi të kërkojë nga këto autoritete shkresat zyrtare të çeljes së fondeve në dispozicion të tyre, pasi duke qënë në cilësinë e një Autoriteti Kontraktor tashmë ajo ka përgjegjësinë dhe detyrimin që rrjedh nga neni 60 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime sipas të cilit, “me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas llogaritjes së fondit limitnxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.... i cili duhet të përmbajëfondin e përllogaritur të vitit ushtrimor...”. Në këtë këndvështrim, DPP në nxjerrjen e fondit limit mjaftohet vetëm me vlerën e fondit limit të dërguar nga Autoritet Kontraktore i cili në shumicën e rasteve nuk ka bashkangjitur shkresat për llogaritjen e tij, duke mos identifikuar/verifikuar angazhimin e fondeve buxhetore të miratuara në dispozicion të Autoriteteve Kontraktore.

2. DPP, nuk disponon një regjistër të të dhënave, i cili të përmbajë të dhënat mbi fondin limit sipas loteve, fondin limit të prokuruar, operatorin ekonomik fitues etj. që të publikohet në faqen zyrtare të APP-së për të mundësuar lehtësisht verifikimin e tyre, mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe fondeve në dispozicion. Ky fakt është konstatuar dhe nga auditimi i mëparshëm por nga ana DPP nuk është zbatuar rekomandimi i KLSH-së në lidhje me të.

3. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, disa prej kriterëve të vecanta të kualifikimit për “Kapacitetin Teknik”, që kanë të bëjnë me afatin e garancisë së mallit, ngjyrën e mallit, pajisjen me librezen shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, etj. konkretisht në procedurat e prokurimit “Blerje automjete”, ndarë në 11 lote, me kufi monetar në total sipas loteve 64,066,666 lekë pa TVSH, “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)”, ndarë në 31 lote me fond limit/kufi monetar në total 1,822,592,504 lekë pa TVSH dhe “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, me fond limit 43,794,015 lekë pa TVSH, nuk janë të njëjta nga njëri lot në tjetrin dhe pse objekti i tenderimit është i njëjtë. Ajo nuk inkurajon pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në konkurim, pasi kriteret duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të plotësojnë kërkesat minimale të tyre. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 2, pika c dhe ç, neni 20, 46 si dhe me VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 27/3.

4. Në procedurën e prokurimit “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, me fond limit 43,794,015 lekë pa TVSH në kërkesat e vecanta për kualifikim është kërkuar vërtetim “për numrin e punëtorëve,.... nga të cilët të paktën 1(një) punonjës të jetë inxhinier druri”. Një kërkesë e tillë tejkalon objektin e kontratës e cila është “kontratë blerje” dhe jo “kontratë shërbimi”. Kërkesa për inxhinier druri do të ishte e domosdoshme dhe minimale nëse kemi të bëjmë me porositjen për prodhim të pajisjeve për mobilim zyrash dhe jo në rastin e kontratës së blerjes së këtyre pajisjeve. AK nuk duhet që në kërkesat e vecanta për kualifikim, të përfshijn kriteret të cilat nuk janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës, por duhet të kërkojë që ata



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

të plotësojnë kërkesat minimale. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

5. Në procedurën e prokurimit “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, me fond limit 128,113,807 lekë (pa TVSH), po ti referohemi kërkesave të AK, specifikave dhe kompleksitetit të objektit të kontratës konstatohet se janë të ndërthurura “blerja” me “shërbimin”. Referuar kërkesave të AK për mobilim zyrash janë të përcaktuara planimetritë, ku përmasat, dizenjimi etj., tregojnë që ndryshimet janë të shumta. Çdo mobilje ka specifikat e veta, në mos nga ana e materialit, dizenjimit, ka ndryshime nga përmasat, ç’ka tregon që, ky objekt kontrate nuk është thjesht “blerje malli” po blerje me porosi. Gjithashtu blerja e tyre, trajtuar si kontratë malli përfshin edhe montimin e tyre. Nisur nga kjo OQB, duhej të evidentonte specifikat dhe kompleksitetin dhe të përcaktonte më saktë llojin e kontratës mall apo shërbim dhe raportin midis tyre, në zbatim të nenit 3/5 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, me ndryshime. Trajtimi i nga OQB si kontratë blerje malli, por që në kërkesat e DT, janë të përfshira kërkesa të cilat janë pjesë e kontratave të shërbimit, e konfuzon procedurën dhe është detyrë dhe përgjegjësi e Njesisë së Prokurimit që bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 57, të përgatisë dokumentet e tenderit duke përcaktuar qartë kriteret në përputhje me dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik, në mënyrë që të mos ketë asnjë ekuivok në përgatitjen e ofertës nga operatorët ekonomikë.

-Gjithashtu vendosja e kriterit të kualifikimit, pika 2.3/3, 4, 5, 6 paraqitja e certifikatave ISO (9001:2008, 14001:2004, 3834:2005 dhe 18001:2007) tejkalon objektin e kontratës pasi bie në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime. Certifikatat kanë të bëjnë jo me cilësinë e produktit por me cilësinë e menaxhimit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet evropiane të cilat kërkohen në rastin e kontratave të shërbimit.

-Kërkesë tjetër e vecantë kualifikimi kërkuar nga AK është dhe pajisja me “leje mjedisore/autorizim mjedisor”, pika 10 e kërkesës për kapacitet teknik (2.3). Vendosja e këtij kriteri përbën tejkalim të objektit të kontratës, pasi procedura e prokurimit ka për objekt “blerje malli” dhe jo “shërbim”.

(Për konstatimet e mësipërme është mbajtur Aktverifikimi nr.1, datë 26.7.2017 dhe nr.2.datë 27.7.2017)

Sqarim mbi observacionet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e sipërme për akteverifikimet e mbajtura nga audituesit shtetërorë të KLSH, të cilat janë dërguar me shkresën nr.4422/6, datë 2.8.2017. Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi jep shpjegimet si më poshtë:

1.Në lidhje me konstatimin “... **Për të konfirmuar nëse autoritetet kontraktore kanë të angazhuar fondet në planet e tyre buxhetore, DPP nuk ka bërë asnjë verifikim, .., pasi duke qënë në cilësinë e një Autoriteti Kontraktor tashmë ajo ka përgjegjësinë dhe detyrimin që rrjedh nga neni 60 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014...**”, subjekti argumenton se: “Në asnjë nen të VKM nr.914 datë 29.12.2014, apo pikë të VKM-së Nr. 28 datë 14.01.2015 nuk e ka të përcaktuar detyrimin e OQB-së të verifikojë nëse Autoritetet Kontraktore i kanë të angazhuara fondet në planet e tyre buxhetore” dhe se: “Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe APP në vendimin e saj nr.86 datë 07.08.2015 me objekt: “Mbi auditimin e procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës 01.01.2014 – 31.12.2014”, vendim i cili është marrë mbi auditimin e KLSH-së, të realizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme,..... ku në faqen 21 të këtij vendimi thuhet: “... Në respektim të dispozitave të sipërcituara, përlllogaritja e të dhënave sasiore dhe fondi limit përkatës për një objekt prokurimi bëhet nga vetë autoriteti kontraktor dhe është praktikë dokumentare që duhet të administrohet nga ky i fundit...”.Argumenti i subjekti **nuk qëndron** me arsyetimin se: OQB, duhej të vepronte sipas përcaktimeve të U MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime, Kapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

publike”, pika 140, ku cilësohet se “Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë” dhe pika 142 “Nëpunësi zbatues **bën krahasimin me nivelin e planifikuar të shpenzimeve** për ...programin buxhetor respektiv, kryen gjithashtu kontrollin e përputhshmërisë ligjore”. Në çdo rast nga OQB nuk ka gjurmë të një verifikimi të tillë mbi angazhimin e fondeve buxhetore. Gjithashtu dhe APP në vendimin e saj nr.86 datë 07.08.2015 me objekt: “Mbi auditimin e procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës 01.01.2014 – 31.12.2014”, ka vënë theksin duke u shprehur vetë se: “*përlllogaritja e të dhënave sasiore dhe **fondi limit** përkatës për një objekt prokurimi bëhet nga vetë autoriteti kontraktor dhe është **praktikë dokumentare që duhet të administrohet nga ky i fundit**”*. Në këtë aspekt ajo që kërkohet nga KLSH është që kjo praktikë dokumentare në lidhje me llogaritjen e fondit limit dhe angazhimin e tij buxhetor duhet të përcillet OQB. Për pasojë, ky pretendim **nuk merret** në konsideratë.

2.Mbi hartimin e DT për procedurën e prokurimit “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarje ushqimi (katering)” me fond limit 1,822,592,504 lekë pa TVSH, për konstatimin e KLSH:

2.1 “...mungesa e kriterit të librezës shëndetësore në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 11, përbën burim rreziku për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse...”, subjekti argumenton se: “organi qendror blerës vendos kriteret për kualifikim me qëllim përzgjedhjen e operatoreve ekonomik të cilët kanë kapacitetet e nevojshme për kryerjen e procedurës për të cilën janë kërkuar këto të fundit. Ndërkohë që kontrata lidhet nëpërmjet operatorit ekonomik fitues dhe autoritetit kontraktor në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi. Pra kërkesa për pajisje me librezë shëndetësore është një kusht që vendoset në momentin e lidhjes së kontratës, dhe jo në momentin e përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues”. Argumenti **nuk merret** në konsideratë me argumentin se OE i është kërkuar që të kenë personel kuzhinier, N/kuzhinier, pjatolarës etj. ndërkohë që këta të fundit duhet të paraqesin librezë pune dhe kontratë pune me OE, pra një kusht i tillë nuk është vendosur si detyrim kontraktor mes OE dhe personelit të punësuar.

2.2 Për konstatimin e KLSH “*Ne lidhje me mos vendosjen e paraqitjes së kontratës së OSHEE dhe ujësjellës kanalizimi UK nga ana e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit*” subjekti sqaron se “ne kërkesat për kualifikim operatori ekonomik nuk mund të kushtëzohet që të lidhi paraprakisht një kontratë para se ai të shpallet fitues i garës, ndërkohë që vërteton pasjen e një kontrate me OSHEE në vendin në të cilin ai ushtron aktivitetin pasi ka sjelle vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike”. Pretendimi **merret** në konsideratë duke u pasqyruar rregullimet në këtë Projektraport Auditimi.

3.Në lidhje me procedurën e prokurimit “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash” me fond limit 43,794,015 lekë pa TVSH për konstatimin e KLSH:

3.1 “...Në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3/2 është kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim “Për numrin e punëtorëve i cili duhet të jetë jo më pak se 25 (njetet e pese) punonjes, “subjekti argumenton se: “Neni 3 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, përcakton se: “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave të tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit...”. Argumenti i subjekti në parim **nuk qëndron**, me arsyetimin se: Në nenin 3/6 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, jepet përcaktimi i saktë i kontratës publike të furnizimit.Në rastin konkret kemi të bëjmë me një objekt miks të kontratës pasi përfshihet dhe shërbimi për montim, por në asnjë rast vlera e montimit nuk tejkalon vlerën e blerjes duke ruajtur



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

në thelb përcaktimin si kontratë blerje. Pavarësisht nga kjo, në rastin konkret ndodhemi para një kontrate mikse blerje shërbim dhe bazuar në nenin 46 të LLP, AK duhet të vendosë kërkesa të tilla, por gjithnjë duke mos anashkaluar kërkesat thelbësore që i përkasin një kontrate shërbimi në mënyrë që këto të jenë në funksion të objektit të kontratës, cka do të thotë se AK duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim, në mënyrë më të plotë dhe jo të cunguar. Për pasojë, observacioni **merret** në konsideratë duke i pasqyruar në Projektraport.

4. Për procedurën e prokurimit “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarje ushqimi (katering)” me fond limit 495,839,715 lekë pa TVSH, për konstatimin e KLSH se: “.. pjesët e pa nevojshme ne DST si shtojca te cilat nuk ishin pjese e objektit te tenderit apo kërkesa e përcaktuar ne germën (a) sigurimi i ofertës te hiqet nëse nuk është kërkuar apo te shënohet qe është kërkuar....”, subjekti sqaron se: “DST janë standarde dhe nuk mund te modifikohen (hiqen apo shtohen) ato mund vetëm te plotësohen ose jo nga ana e Organit Qendror Blerës”. Argumenti nuk qëndron pasi DST janë të miratuara për të gjitha llojet e procedurave të prokurimit dhe nga ana e AK, plotësohen ato të cilat i përkasin llojit të procedurës së shpallur për konkurim. Konkretisht OQB, nuk ka hedhur në konkurim “Marrëveshje kuadër”, por procedurë prokurimi “Tender i hapur”, për rrjedhojë AK ka detyrim t’ju referohet DST të kësaj procedure, si dhe të mbajë të pandryshueshme ato kërkesa të DST për të cilat nuk lejohet të ndryshohen. Nëse AK zhvillon procedurën e prokurimit për “Blerje makinash”, apo “Shërbim katering”, plotësimi i formularit që ka ta bëjë me blerje karburanti nuk është kërkesë e DST për këtë procedurë dhe nuk kërkohet e të bëhet pjesë e DT, siç keni argumentuar ju. Përsa i përket kërkesës mbi “sigurimin e ofertës”, argumenti juaj nuk qëndron, pasi fakti nëse kërkohet ose jo përcaktohet nga AK, i cili ose e kërkon dhe e vendos tek shtojcat, ose nëse nuk e ka si kërkesë nuk e vendos tek shtojcat. OE kane detyrë që nëse është kërkuar ta plotësojnë. **Observacioni nuk pranohet.**

5. Ne lidhje me konstatimin se “kërkesat duhen unifikuar” subjekti sqaron se “unifikimi është i pamundur pasi normat janë te ndryshme dhe vendet ne te cilat do te serviret ushqimi janë po te ndryshëm dhe me specifika te ndryshme, gjithashtu vëmë ne vëmendje se unifikimi i tyre do te sillte përfshirjen ne një lot te vetëm, gjë qe do e bënte shume të vështirë pjesëmarrjen masive te operatoreve ekonomik dhe do te kufizonte tregun vetëm ne disa operatore duke bere te pamundur pjesëmarrjen e biznesit te vogël dhe te mesëm (nisur kjo nga madhësia e kontratës)”. Pretendimi nuk merret parasysh me aargumentin se: Unifikimi i specifikimeve teknike është plotësisht i realizueshëm dhe nuk kushtëzohet as nga vendi dhe as nga normat, pasi ka të bëjë me cilësinë e artikujve ushqimorë të kërkuar nga të gjitha AK.

6. Ne lidhje me mos pasqyrimin e njësisë të kërkesave të autoriteteve kontraktore në DST sqarojmë se një pjesë e kërkesave të cilat janë kërkesa për kualifikim nuk mund të pasqyrohen pasi ato përpunohen dhe vendosen në mënyrë të drejte midis lotëve nga ana e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit. Sqarojmë se: Argumentimi juaj **nuk qëndron**, pasi nuk mund të hiqen nga ana juaj kritere të kërkuara nga AK dhe që kanë të bëjnë drejtëpërsëdrejti me cilësinë e shërbimit, sigurinë shëndetësore, vendin e shërbimit etj.

7. Ne lidhje me mos përcaktimin sakte të termave të referencës sqarojmë se të gjitha kërkesat e ardhur nga autoritetet kontraktore të cilat kanë pasur të bëjnë me momentin e lidhjes së kontratës dhe kanë pasur ndikim në kosto e përgatitjes së ushqimit, janë vendosur në terma reference por në tërësi kjo shtojcë duke qene se OQB prokuron për llogari të autoriteteve kontraktore nuk mund të plotësohet me kritere të cilat janë komplet kompetence e AK-e. Sqarojmë se: Argumenti juaj nuk qëndron, pasi AK ka për detyrë të lidhë kontratën dhe të ndjekë zbatimin e saj. Sipas DST, specifikime teknike, etj. janë shtojca të cilat i përkasin procedurës së prokurimit, pra që përcaktohen nga OQB (në këtë rast i autorizuar nga AK të kryejë funksionet e tyre, deri në lidhjen e kontratës). AK së bashku me kërkesën e tyre ju kanë dërguar “termat e referencës” dhe “specifikimet teknike” (kompetenca e tyre), por është detyra juaj t’i bëni pjesë të DT (shtojcat).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

5. Zhvillimi i procedurave të prokurimit nga njoftimi i kontratës deri te publikimi njoftimit të shpalljes së fituesit.

(Burimi i të dhënave për auditimin e kësaj pike të programit është marrë nga Sistemi i Prokurimeve Elektronike në faqen zyrtare të APP-së si dhe nga dosjet fizike të procedurës së prokurimit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme).

Baza ligjore në auditim.

-Ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet nënligjore të cituar më sipër në pikën 4.

Për shkak të volumit të dosjeve të tenderave u përzgjedh metoda me zgjedhje rastësore, metoda e gjurmimit të dokumentacionit. Çdo paqartësi që doli nga procesi i auditimit është diskutuar me personat kompetent që kanë ndjekur procesin e prokurimit të audituar.

Për **vitin 2016**, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme në cilësinë e Organit Qendror Blerës, ka zhvilluar për llogari të Autoriteteve Kontraktore të njohura me ligj, 44 procedura prokurimi të ndarë në 149 lote gjithsej, me fond limit sipas loteve në total në vlerën 5,283,402,179 lekë pa TVSH dhe me vlerë të kontratave të prokuruar 4,032,226,727 lekë pa TVSH.

- Zhvillimi i procedurave të prokurimit në vështirimin e përgjithshëm, është bërë duke vlerësuar në shumicën e rasteve ofertën me vlerën më të ulët, bazuar dhe në rekomandimet e mëparshme të KLSH, dërguar me shkresën nr. 606/7, datë 4.10.2016.

-Në shumicën e rasteve në seancën publike të hapjes së ofertave të hedhura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatohet se operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike ose dokumentacionin ligjor/technik të kërkuar. Pjesmarrja e tyre bëhet vetëm për të siguruar konkurrencën numerike në seancën publike të hapjes së ofertave, duke krijuar mundësinë që konkurimi të fillojë me një operator të vetëm sipas kërkesave të nenit 73, pika 1 VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime. Kjo mënyrë konkurimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues, operatorin e mbetur në garë si e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin Autoriteti Kontraktor (OQB) duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës si organ kompetent i hetimit të konkurrencës së pandershme. Për pasojë, mos publikimi nga operatorët ekonomikë i ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në SPE, kur konstatohen fenomene të tilla nuk krijon kushtet për konkurrencë.

-Në vlerësimin e ofertave ekonomike, KVO ka marrë në konsideratë dhe ka vlerësuar ofertën e paraqitur nga operatorët ekonomikë dhe pse ajo nuk është plotësuar sipas rubrikave dhe kërkesave të shtojcës 1, të DT, si dhe kërkesave të nenit 17 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, sipas të cilave plotësohet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij. Një veprim i tillë nga KVO nuk e përjashton atë nga detyrimet e nenit 10, dhe 14 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

Në mënyrë të detajuar mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit të audituara me zgjedhje janë si vijon:

I-Në procedurën e prokurimit “**Blerje automjete**” e cila është ndarë ndarë 11 lote, me kufi monetar në total sipas loteve 64,066,666 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të prokuruar gjithsej 61,988,583 lekë pa TVSH konstatohet se:

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË**

Nga 11 procedura të shpallura (lote), janë zhvilluar 11 me vlerë kontrate të prokuruar 61,988,583 lekë, pa TVSH listuar si më poshtë:

-Loti I, “Blerje mikrobuz Min 8+1 për Insitutin e Mjeksisë Ligjore”, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH

-Loti II, “Blerje automjeti për Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH

-Loti III, “Blerje automjete për SHISH” me fond limit 21,250,000 lekë pa TVSH

-Loti IV, “Blerje automjeti për Gardnë e Republikës” me fond limit 7,375,000 lekë pa TVSH

-Loti V, “Blerje fuoristrade për Gardnë e Republikës” me fond limit 3,625,000 lekë pa TVSH

-Loti VI, “Blerje mikrobuz Min 11+1 për Gardnë e Republikës” me fond limit 10,666,667 lekë pa TVSH

-Loti VII, “Blerje fuoristrada për Agjencinë Kombntare të Bregdetit” me fond limit 4,166,666 lekë pa TVSH

-Loti VIII, “Blerje fuoristradn për Sekretariatit Teknik të Knshillit Kombntar të Ujit” me fond limit 3,500,000 lekë pa TVSH

-Loti IX, “Blerje automjete për ALUIZNIN” me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH

-Loti X, “Blerje fuoristradë për AKSHI” me fond limit 4,900,000 lekë pa TVSH

-Loti XI, “Blerje mjet vinc, pirun me motor për DPRMSH” me fond limit 2,083,333 lekë pa TVSH

Të dhënat e procedurës dhe të dhënat sipas loteve të audituara në SPE janë pasqyruar në tabelat nr.1 dhe nr.2.

Tabela nr. 1**Të dhëna përmblledhëse mbi procedurën “Blerje automjete”**

Urdhë Prokurimi nr. 5, datë 23.02.2016 F. limit: 64,066,666 lekë pa TVSH	NJHD me urdhrin nr. 5, datë 23.02.2016 1. 2. 3.	KVO me urdhrin nr. 5/2, datë 16.03.2016 1. 2. 3.
Procedura e prokurimit -Procedurë e hapur.	Lloji i kontratës: -Blerje mallra	Burimi i Financimit: -Buxheti shtetit.
Data e hapjes së tenderit 18. 03.2016, ora 11. ⁰⁰	Afati kontratës: 2 muaj .	Ankimime në AK - 1

Tabela nr. 2**Të dhëna mbi operatorët pjesmarrës në lotet e audituara me zgjedhje procedurën “Blerje automjete”**

Lotet	Operatorët ekonomike (ofertuesit)	Fondi Limit pa TVSH	Vlera e ofertës pa TVSH publikuar në SPE	Oferta Fituese pa TVSH	Diferenca
III	1..... 2..... 3..... 4.....	21,250,000	20,825,000 20,966,525 20,332,000 -	20,332,000	-918,000
X	1..... 2..... 3..... 4.....	4,900,000	4,700,000 - - 4,459,583	4,459,583	-440417
VII	1..... 2..... 3.....	4,166,666	- - 4,160,000	4,160,000	
IV	1. 2. 3.	7,375,000	7,125,000 7,305,000 -	7,125,000	-250,000
V	1. 2. 3.	3,625,000	3,600,000 - -	3,600,000	-25,000
VI	1. 2. 3.	10,666,667	10,600,000 - -	10,600,000	-66,667



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Bazuar në të dhënat e tabelës nr. 2, mangësitë trajtohen si vijon:

1.”Blerje automjete Loti III-SHISH”:

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik (kntu e më poshtë SPE) janë paraqitur 4 Operatorë Ekonomikë nga të cilët operatori ekonomik, në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton pa ofertë. KVO ka klasifikuar në vend të parë ofertën e Operatorit Ekonomik “...” me vlerën më të ulët 20,332,000 lekë pa TVSH, e cila përmbush dokumentacionin, sipas kërkesave të DT të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.”Blerje fuoristrade Loti X-AKSHI”:

Në SPE janë paraqitur 4 Operatorë Ekonomikë nga të cilët operatori, dhe ..., rezultojnë pa ofertë në SPE. KVO ka klasifikuar në vend të parë ofertën e Operatorit Ekonomik “...”, me vlerën më të ulët 4,459,583 lekë pa TVSH.

Nga auditimi në SPE i dokumentacionit të operatorit fitues konstatohet se:

-specifikimet teknike të përshkruara në katalogun teknik të mallit të paraqitur nga ofertuesi nuk përputhen me të dhënat e përkthimit në aktin noterial nr. 534 rep. datë 15.3.2015, veprim në kundërshtim me formularin “specifikimet teknike loti X”, duke përbërë kusht skualifikues për ofertuesin.

3.”Blerje fuoristrada Loti VII-AKB”:

Në SPE janë paraqitur 3 Operatorë Ekonomikë nga të cilët operatori....dhe ..., rezultojnë pa ofertë ekonomike. KVO ka klasifikuar në vend të parë ofertën e Operatorit Ekonomik “....”, që është dhe oferta e vetme e paraqitur me vlerën 4,160,000 lekë pa TVSH. Me shkresën nr.449, datë 25.3.2016 OQB ka kërkuar informacion nga operatori “....”, i cili është shpallur fitues, pasi në momentin e shqyrtimit të ofertave rezultoi se oferta e tij në rubrikën “emri i ofertuesit” rezulton me emrin (K). Me shkresën nr.449/1, datë 9.3.2016 operatori fitues ka kthyer përgjigje duke bashkangjitur formularin e ofertës me saktësimin e emrit.

4.Lotet V dhe VI, janë paraqitur nga tre oferta, ku dy prej ofertuesve në të dy lotet nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike dhe për rrjedhojë procedura ka vazhduar me një ofertues, operatorin ekonomik “...” shpk. Nga knqyrja e ofertës ka rezultuar se nga ky OE janë plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në DT.

Për lotin IV, nga knqyrja e dokumentacionit të paraqitur nga 2 ofertuesit e kualifikuar ka rezultuar se nga operatori ekonomik “...” nuk janë plotësuar këto kërkesa të specifikuara në DT.

-Nuk është paraqitur vërtetim xhiroje për vitet 2014 dhe 2015 nga Administrata Tatimore;

-Nuk është paraqitur vërtetim mbi pagesat e detyrimeve tatimore nga Administrata Tatimore, por është mjaftuar vetëm me vetëdeklarim (FDP);

-Nuk është paraqitur vërtetim mbi pagesat e sigurimeve shoqërore nga Administrata Tatimore;

-Nuk është paraqitur “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike”, sipas shtojcës 6, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT, kapitulli 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, germa b;

-Nuk është paraqitur “Deklaratë mbi konfliktin e interesave”, sipas shtojcës 7 në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT, kapitulli 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1 germa c;

-Nuk është paraqitur “Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore”, sipas shtojcës 9, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT, kapitulli 1 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, pika 1, germa c, ku cilësohet: “..., si dhe vetëdeklarimin e subjektit sipas shtojcës 9 “Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore”;

-Përsa i përket plotësimit të specifikimeve teknike, në DT janë përcaktuar specifikimet teknike sipas kërkesës së AK “Grada e Republikës”, por nga operatori ekonomik është paraqitur vetëm përkthim pjesor i katalogut mbi specifikimet teknike, ku nuk ka të dhëna mbi të gjitha kërkesat



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

mbi specifikimet teknike të përcaktuara në DT. Kjo kërkesë e DT rezulton e pa plotësuar nga operatori ekonomik.

-Gjithashtu nuk janë plotësuar këto specifikime teknike:

Vëllimi i motorit kërkuar	≥ 1800 kubik	paraqitur 1798 kubik
Fuqia motorike kërkuar	≥ 170 KF	paraqitur 132 KF

Mbi ankimet: Për mosplotësim të specifikimeve teknike, kundrejt OE “P” shpk është paraqitur ankesë nga OE “H” shpk, sipas shtojcës 20 “Formulari i ankesës pranë AK”, protokolluar me nr.488, datë 08.04.2016 në MPB. AK me shkresë nr. 488/1, datë 12.04.2016 i ka kthyer përgjigje për mos shqyrtim të ankesës, pasi ka qenë jashtë afatit të ankimit prej 7 ditësh të përcaktuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 78/5.

5.Nga të dhënat e tabelës nr.2, për Lotin IV me objekt **“Blerje automjete për Gardën e Republikës”** me fond limit 7,375,000 lekë (pa tvsh) janë paraqitur 3 ofertues, 1 prej të cilëve nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe është s’kualifikuar dhe nga dy operatorët ekonomikë të mbetur në garë, është kualifikuar si fitues dhe është lidhur kontrata me operatorin ekonomik “P” shpk i cili ka paraqitur ofertën me vlerën më të ulët prej 7,125,000 lekë (pa tvsh), por që nuk ka plotësuar një sërë kriteresh të cituara më lart.

II- Në procedurën e prokurimit **“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering)”** e ndarë ndarë 31 lote, me kufi monetar gjithsej sipas loteve 1,822,592,504 lekë pa TVSH (mbi kufirin e lartë monetar) dhe vlerë kontrate të prokuruar gjithsej 1,472,073,789 lekë pa TVSH konstatohet se:

Nga 31 procedura të shpallura listuar në lote si më poshtë, janë zhvilluar 17 me vlerë kontrate të prokuruar 1,472,073,789 lekë pa TVSH dhe janë anuluar 15 procedura.

-Loti I “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Lnvizshme Territoriale të Kufirit dhe Migracionit Rradhimë-Vlorë” me fond limit 18,265,632 lekë pa TVSH

-Loti II “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Renea, Tiranë” me fond limit 20,020,958 lekë pa TVSH

-Loti III “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Komisaratin e policisë NSH, Tiranë” me fond limit 48,462,688 lekë pa TVSH

-Loti IV “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qëëdrnë Spitalore Xh. Kongoli, Elbasan” me fond limit 70,580,323 lekë pa TVSH

-Loti V “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obsetrik-Gjinekologjik, Mbretëresha Geraldinë, Tiranë” me fond limit 9,142,574 lekë pa TVSH

-Loti VI “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal, Durrës” me fond limit 112,209,618 lekë pa TVSH

-Loti VII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal, Lezhë” me fond limit 21,727,038 lekë pa TVSH

-Loti VIII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Institutin e Veçantë Shnëdetësor të Burgosurve” me fond limit 3,936,457 lekë pa TVSH

-Loti IX “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë” me fond limit 127,980,593 lekë pa TVSH

-Loti X “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 4001 Vaqar, Pezn, rrap Treshit, Babrru, Tiranë” me fond limit 123,643,415.3 lekë pa TVSH

-Loti XI “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 4001 Korçë” me fond limit 5,232,046.5 lekë pa TVSH

-Loti XII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 4001 Gjirokastrë” me fond limit 5,185,986 lekë pa TVSH

-Loti XIII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 4001 Kukës” me fond limit 5,098,922.9 lekë pa TVSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

-Loti XIV “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 4001 Burrel” me fond limit 5,087,407.8 lekë pa TVSH

-Loti XV “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 5001(5008) KDS” me fond limit 83,210,896.5 lekë pa TVSH

-Loti XVI “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 5001(5009) Zall-Herr, Tiranë” me fond limit 22,220,012.8 lekë pa TVSH

-Loti XVII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 5001(5010) Bunavi,” me fond limit 143,755,145.7 lekë pa TVSH

-Loti XVIII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 3001, 3002, 3003, 3008 Rinas, Tiranë” me fond limit 18,075,488.3 lekë pa TVSH

-Loti XIX “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 3004, 3005 Kucovë” me fond limit 18,293,601.7 lekë pa TVSH

-Loti XX “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 3006 Farkn, Tiranë” me fond limit 54,895,845.8 lekë pa TVSH

-Loti XXI “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 2001, 2002, 2006, Plepa, Durrës” me fond limit 12,860,720.5 lekë pa TVSH

-Loti XXII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 2004, Kepi Palit Durrës” me fond limit 45,961,642.7 lekë pa TVSH

-Loti XXIII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 2003, 2004, 2012, PashalimanVlorë” me fond limit 72,014,956.7 lekë pa TVSH

-Loti XXIV “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1001, 1002, 1003, 1004, 1020, Tiranë” me fond limit 217,208,238.3 lekë pa TVSH

-Loti XXV “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1060, Babrru, Tiranë” me fond limit 83,070,367.5 lekë pa TVSH

-Loti XXVI “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1040, 1050 Zall-Herr 2, Tiranë” me fond limit 204,072,441 lekë pa TVSH

-Loti XXVII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1010, Vau Dejns, Shkodër” me fond limit 85,859,679.8 lekë pa TVSH

-Loti XXVIII “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1030, Poshnje, Berat” me fond limit 167,291,695.7 lekë pa TVSH

-Loti XXIX “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 6630, Rrapi Treshit, Tiranë” me fond limit 54,837,184.2 lekë pa TVSH

-Loti XXX “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 6620, Sauk, Tiranë” me fond limit 40,506,932.1 lekë pa TVSH

-Loti XXXI “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 6640, Rrapi Treshit&KDS, Tiranë” me fond limit 49,864,588.7 lekë pa TVSH.

Të dhënat e procedurës dhe të dhënat sipas loteve të audituara janë pasqyruar në tabelat nr.3 dhe nr.4.

Tabela Nr. 3 Të dhëna përmblledhëse mbi procedurën “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)”

Urdhë Prokurimi nr.15 datë 27.04.2016 F. limit: 1,822,592,504 lekë pa TVSH	NJHD me urdhrin nr.15, datë 27.04.2016 1. 2. 3.	KVO me urdhrin nr. 15/6, datë 14.06.2016 1. 2. 3.
Procedura e prokurimit: -Tender i hapur mbi kufirin e lartë monetar.	Lloji i kontratës: -shërbim	Burimi i Financimit: -Buxheti shtetit.
Data e hapjes së tenderit: 17. 06.2016, ora 11. ⁰⁰	Afati kontratës: sipas përcaktimit në lote	Ankime në AK - 2

Tabela nr. 4 Të dhëna sipas loteve të audituara me zgjedhje në procedurën “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)”

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË**

Lotet	Operatorët ekonomike (ofertuesit)	Fondi Limit pa TVSH	Vlera e ofertës pa TVSH, publikuar në SPE	Oferta Fituese pa TVSH	Diferenca
VI	1..... 2.....	112,209,618	- 111,847,618	111,847,618	-362,000
XVII	1..... 2..... 3.....	143,755,146	136,131,110 143,556,986 143,093,015	111,847,110	-7,624,036
XXIV	1.....	217,208,238	214,460,917	214,460,917	-2,747,321
XXV	1..... 2..... 3.....	83,070,367	- 81,974,393 81,977,013	81,974,393	-1,095,974
XXVI	1. 2.....	204,072,441	202,785,094 203,105,000	202,785,094	-1,287,347

Bazuar në të dhënat e tabelës nr. 4, mangësitë trajtohen si vijon:

1. "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal, Durrës, Loti VI"

Në SPE janë paraqitur 2 Operatorë Ekonomikë nga të cilët operatori ekonomik K, rezulton pa ofertë. KVO ka klasifikuar në vend të parë ofertën e Operatorit Ekonomik "Sh", që është dhe oferta e vetme e paraqitur me vlerën 111,847,618 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator konstatohet se:

-Formulari i ofertës, nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat sipas kërkesave të nenit 17 të nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, ku të jepet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij, si dhe shtojcës 1 të DT.

2. "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 5001(5010) Bunavi, Vlorë, Loti XVII"

Në SPE janë paraqitur 3 Operatorë Ekonomikë. KVO ka klasifikuar në vend të parë ofertën e Operatorit Ekonomik "Sh", me vlerë 136,131,110 lekë që është dhe vlera më e ulët.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se:

-Formulari i ofertës, nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat sipas kërkesave të nenit 17 të nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, ku të jepet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij.

4. "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1001, 1002, 1003, 1004,1020, Tiranë" Loti XXIV.

Në SPE është paraqitur vetëm Operatori Ekonomik K me vlerë oferte 214,460,917 i cili është kualifikuar dhe klasifikuar në vend të parë nga KVO.

5. "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1060, Babrru, Tiranë" Loti XXV.

Në SPE janë paraqitur 3 operatorë ekonomikë, ku Operatori K nuk ka paraqitur ofertë për këtë lot, ndërkohë që po t'i referohemi lotit XXIV trajtuar më lart, konstatohet se për këtë lot ky operator ka paraqitur ofertë si operator i vetëm, duke u klasifikuar dhe shpallur fitues. Nga krahasimi i ofertave nga njëri lot në tjetrin rezultojnë që pjesëmarrja e operatorëve vetëm për të siguruar konkurrencë në seancën publike të hapjes së ofertave në SPE, krijon mundësinë e ekzistencës së marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin duhet të sinjalizohet Autoriteti i Konkurrencës. Nga auditimi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, rezultojnë se KVO në procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave datë 29.6.2016, nuk është shprehur fare për pjesëmarrjen e operatorit ekonomik S, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 12, pika 2/ç, d. Operatori S në SPE dhe pse nuk konfigurohet me shenjë përkatëse të dokumentacionit, rezultojnë të ketë hedhur në sistem ofertën e tij, ku oferta



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

ekonomike është me vlerë oferte 81,977,013 lekë pa TVSH. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik S, rezulton se ai nuk përmbush kriteret për kualifikim.

KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit ka klasifikuar në vend të parë ofertën e Operatorit Ekonomik “Sh”, me vlerë 81,974,393 lekë pa TVSH e cila krahasuar dhe me ofertën e operatorit S është vlere më e ulët.

Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit “S”, konstatohet se:

-Formulari i ofertës, nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat sipas kërkesave të nenit 17 të nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, ku të jepet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij.

6. “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak 1040, 1050 Zall-Herr 2, Tiranë” Loti XXVI.

Në SPE janë paraqitur 2 Operatorë Ekonomik nga ku KVO ka kualifikuar dhe klasifikuar në vend të parë ofertën e operatorit ekonomik “S” me vlerën më të ulët 202,785,094 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se:

-Formulari i ofertës, nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat sipas kërkesave të nenit 17 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, ku të jepet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij.

Për procedurën e prokurimit “**Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)**” me kufi monetar 1,822,592,504 lekë pa TVSH, ka patur ankim pranë AK në lidhje me vlerësimin e ofertave për lotet XVIII, XX, XXI, XXII dhe XXVIII. AK ka bërë rivlerësimin e ofertave për lotet e mësipërme duke klasifikuar ofertat fituese dhe vënë në dijeni ankuesit (operatorët ekonomikë).

III. Në procedurën e prokurimit “**Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering II)**” e ndarë ndarë 15 lote, me kufi monetar gjithsej sipas loteve 495,839,615 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të prokuruar gjithsej 180,602,054 lekë pa TVSH konstatohet se:

Nga 15 procedura të shpallura 7 ose 47 % e tyre rezultojnë të pasukseshme, 6 prej tyre kanë rezultuar në fund të konkurrimit me një ofertues që plotëson kriteret e përcaktuara në DT, si dhe vetëm në 2 raste ka rezultuar me më shumë se 2 ofertues të kualifikuar.

Procedurat e prokurimit për lotet I, III, VI, VII, VIII, IX dhe X, të cilat kanë dështuar për shkak të mungesës së konkurrencës, me shkresat nr. 32/6, datë 07.12.2016 dhe nr. 32/12, datë 28.12.2016 kanë dalë urdhrat e Titullarit të Organit Qendror Blerës (OQB) për anullim të procedurave të prokurimit si dhe me shkresat nr. 32/8, datë 07.12.2016 dhe nr. 32/13, datë 28.12.2016 është njoftuar APP. Në vazhdimësi me shkresën nr. 84, datë 20.01.2017 ju është kërkuar AK, për lotet përkatëse të anuluar në vitin 2016, të rishikojnë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, afatet dhe ridërgimin bashknëgjitur kërkesës pranë OQB.

Të dhënat e procedurës dhe të dhënat sipas loteve të audituara janë pasqyruar në tabelat nr.5 dhe nr.6.

Tabela nr.5

Të dhëna përmbledhse mbi procedurën Katering II)

Urdhë Prokurimi nr. 32, datë 09.09.2016 -Fondi limit 495,839,715 lekë (pa TVSH) -Ndarë në 15 lote	NJHD me urdhrin nr. 32, datë 19.09.2016 1. 2. 3.	KVO me urdhrin nr. 32/3, datë 05.10.2016 4. 5. 6.
Procedura e prokurimit -Procedurë e hapur.	Lloji i kontratës: -Shërbim	Burimi i Financimit: -Buxheti shtetit.
Data e hapjes së tenderit Buletini nr. 38, datë 26.09.2016. 11.11.2016, ora 11. ⁰⁰	Afati i kontratës: deri në tre vjet .	Ankimime në AK - 2 Ankimime në KPP -2
Formulari i njoftimit të kontratës me shkresë nr. 32/1, datë 22.09.2016 Formulari i Njoftimit fituesit, shkresa 32/16, datë 28.12.2016	Autorizim për lidhje kontrate për AK, me shkresën nr. 5/5, datë 20.04.2016	Procesverbali mbi hartimin e DT, datë 22.09.2016 Procesverbali i KVO, datë 24.11.2016 Raporti përmbledhës me shkresë nr. 32/15, datë 28.12.2016



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Tabela nr.6

Të dhëna mbi operatorët

Lotet	OE (pjesëmarrës)	Fondi Limit	Vlera e ofertës	Oferta Fituese	Diferenca
I	1.	15,754,932	-	-	-
II	1.	65,177,265	64,526,384	64,526,384	650,881
III	1.	124,831,821	-	-	-
IV	1.	20,107,271	19,701,225	19,901,225	206,046
	2.		-	-	-
	3.		18,189,725	S'kualifikohet	-
V	1. ...	4,501,007	-	-	-
	2.		4,482,260	4,482,260	18,747
VI	1.	4,456,111	-	-	-
VII	1.	4,411,415	-	-	-
	2.		4,274,900	S'kualifikohet	-
	3.		-	-	-
VIII	1.	4,280,041	4,160,850	Skualifikohet	-
			-	-	-
IX	1.	15,092,592	-	-	-
	2.		13,086,846	S'kualifikohet	-
	3.		14,638,730	S'kualifikohet	-
X	1.	15,217,316	-	-	-
XI	1.	46,201,322	43,385,271	S'kualifikohet	-
	2.		40,323,375	S'kualifikohet	-
	3.		45,749,866	45,749,866	451,456
XII	1.	12,860,721	-	-	-
	2.		-	-	-
	3.		12,478,074	12,478,074	382,647
XIII	1.	45,961,643	-	-	-
	2.		-	-	-
	3.		43,205,589	43,205,589	2,756,054
XIV	1.	76,479,226	-	-	-
	2.		70,777,670	-	-
	3.		71,036,104	71,036,104	5,443,122
XV	1.	40,506,932	39,289,231	S'kualifikuar	-
	2.		39,048,660	-	-
	3.		36,008,520	36,008,520	4,498,412
	4.		37,856,201	-	-
	5.		39,774,450	-	-
	Vlera totale limit e kontratës	495,839,615			

Bazuar në të dhënat e tabelës nr. 6, mangësitë trajtohen si vijon:

Procedura e prokurimit është hapur më datë 11.11.2016, ndërsa shqyrtimi i ofertave nga KVO është bërë më datë 24.11.2016, sipas Procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim nga KVO.

Procedura e prokurimit “Shërbim katering për RU të Forcave të Armatosura”, lotet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV dhe XV:

1.Loti IV, ka rezultuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Vlerësimi nga KVO	Oferta ekonomike
1	Kualifikohet	19,901,225
2	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	-
3	S'kualifikuar për: -Nuk ka paraqitur leje higjeno-sanitare të mjetit frigorifik -Pagesa e OSSHEE, nuk përfshin pagesën e muajit shtator -Nuk ka paraqitur vërtetim për sig-shoq nga AT Diploma e kimistit është fotokopje Akti teknik I ambjentit është fotokopje Nuk plotëson xhiron mesatare të tre viteve	18,189,725

■ OE “L”

Nga KVO, është argumentuar se OE “L” nuk ka plotësuar pikën 1/d tek “Kriteret e veçanta për kualifikim” shtojca 7, të DT, pasi vërtetimi i debisë lëshuar nga OSSHE nuk përfshin pagesën për faturën e **muajit shtator**”, gjë e cila nuk është e përcaktuar në DT si afat. Gjithashtu, vërtetimi është lëshuar nga OSSHE më datë 12.10.2016, afat që tregon se nuk ka përfunduar koha e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

përlllogaritjes së detyrimeve dhe pagnsës së energjisë së muajit shtator. Argumentimi i KVO-së nuk është i bazuar.

2.Lotin V, ka rezultuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Vlerësimi nga KVO	Oferta ekonomike
1	S'kualifikohet	-
2	Kualifikohet	4,482,260

▪ OE "G"

-Vërtetim nga Prokuroria, Deklaratat (E-Sig 025) mbi pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, Certifikata EN-ISO 22000:2005, Sigurimi i ofertës (shtojca 3), etj. Të paraqitura më poshtë janë fotokopje;



Sipas numrit të protokollit rezulton që më datë 08.11.2016 Prokuroria të ketë lëshuar vërtetimin e parë mbi gjendjen e "procedimin penal", të OE "G".



-Certifikatat e cilësisë (ISO) nuk janë të përkthyer të vërtetuara te noteri dhe janë pa vulën apostile, në kundërshtim me kërkesat e DT;

-Deklaratat (E-Sig 025) mbi pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale janë pa vulën e AT, në kundërshtim me kërkesat e DT "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik" pika 9.

Sa më sipër, OE "G" është kualifikuar edhe pse nuk plotëson disa Kërkesa të DT.

3.Loti XI, ka rezultuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Vlerësimi nga KVO	Oferta ekonomike
1.	Tërhequr, sipas shkresës së protokolluar në MPB me nr. 1309, datë 24.11.2016.	-
2.	S'kualifikuar për: -Diploma e kuzhinierit fotokopje -Janë paraqitur specifikimet teknike, por nuk është paraqitur deklarata sipas shtojcës 6 -Nuk është paraqitur deklarata mbi gjendjen gjyqësore shtojca 9	40,323,375
3.	Kualifikuar Ka plotësuar të gjitha kriteret	45,749,866



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

4	KVO nuk është shprehur në Procesverbal mbi pjesëmarrjen e këtij OE, pavarësisht mosplotësimit të dokumentacionit sipas kërkesave të DT.	-
---	---	---

Janë paraqitur 4 ofertues, nga të cilët ofertuesi “D” është tërhequr nga gara sipas shkresës së protokolluar në MPB nr. 1309, datë 24.11.2016 (nga lotet IX, XI, XV), si dhe OE “N”, nuk është evidentuar në procesverbal.

- OE “L” dhe “S” janë paraqitur si bashkim shoqërisht, por nga ana e KVO-së nuk është trajtuar në Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave, fakti se midis këtyre dy operatorëve nuk ka kontratë apo marrëveshje noteriale bashkëpunimi, siç përcaktojnë kërkesat e DT, “Kriteret e përgjithshme”, pika 3, ku cilësohet: “Nëse oferta dorëzohet si bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen a) Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i OE është krijuar zyrtarisht dhe b) Prokura e posaçme”.
- OE “S” shpk, ka plotësuar të gjitha kërkesat e DT.

Mbi ankimet: Bazuar në nenin 20 “Ankesa”, mbi procedurën e mësipërme është paraqitur ankimimi sipas shtojcës 20 nga OE “L” drejtuar OQB. Pas kalimit të procedurave të ankimimit, në përfundim nga KPP është marrë vendimi nr. 984/2016 ku është vendosur që OQB të vazhdojnë procedurat e mëtejshme, pasi OE nuk ka të drejtë. Shqyrtimi i tyre është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 78.

4. Loti XII, ka rezultuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Vlerësimi nga KVO	Oferta ekonomike
1	Nuk ka paraqitur ofertë	-
1	Nuk ka paraqitur ofertë	-
3	Kualifikuar	12,478,074

- OE D.

-Nuk janë paraqitur kontrata për shërbime të ngjashme në vlerën 40 % të fondit limit. Nga OE janë paraqitur kontrata furnizimi dhe jo shërbimi, në kundërshtim me DT, “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik-financiar” pika 1;

-Guzhinierja nuk ka eksperiencën e kërkuar në DT mbi 1 vit. Kontrata e punës, Libreza e Punës nuk ka asnjë ditë pune, si dhe Certifikata profesionale nr. 041, datë 30.05.2016;


-Certifikatat ISO janë të papërkthyer, noterizuara dhe pa vulën apostile;

Sa më sipër, OE “D” shpk është kualifikuar edhe pse nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT.

5. Loti XIII, ka rezultuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Vlerësimi nga KVO	Oferta ekonomike
1	S’kualifikohet	-
2	S’kualifikohet	-
3	Kualifikohet	43,205,589

-Nuk janë paraqitur kontrata për shërbime të ngjashme në vlerën 40 % të fondit limit. Nga OE janë paraqitur kontrata furnizimi dhe jo shërbimi, në kundërshtim me DT, “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik-financiar” pika 1;





KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Nr. 65/31 Prot.

Tiranë, më 18.06.2016

VERTETIM

Me anën e të cilit vërtetohet se midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe operatorit ekonomik "Vilaznia" sh.p.k. janë lidhur dhe realizuar kontratat e furnizimit si më poshtë:

- Nr. 05\4 datë 06.01.2016 me objekt "Blerje fruta, perime dhe bulmet" me vlerë totale 44,249,544 lekë me tvsh.
- Nr. 10\5 datë 26.01.2016 me objekt "Blerje bukë" me vlerë totale 20,403,835 lekë me tvsh.
- Nr. 10\6 datë 26.01.2016 me objekt "Blerje ushqime bazë" me vlerë totale 11,912,534 lekë me tvsh.

Lëshohet ky vërtetim sipas kërkesës së të interesuarit.

-Punonjësit nuk kanë eksperiencën e duhur, më datë 30.05.2016 kanë marrë Certifikatën e kualifikimit si kuzhinierë.

-Certifikatat ISO janë të papërkthyer, noterizuara dhe pa vulën apostile.

Sa më sipër, OE "D" shpk është kualifikuar edhe pse nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT.

6.Loti XIV, ka rezultuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Vlerësimi nga KVO	Oferta ekonomike
1	Nuk ka paraqitur ofertë	-
2	Kualifikuar	70,777,670
3	Kualifikuar	71,036,104

OE "N" shpk, nuk e ka plotësuar Formularin e ofertës sipas shtojcës 1. Pasi ka dhënë vetëm vlerën në total dhe jo sasinë e kalorive, sipas normave, numrin e sipas kërkesave të racioneve dhe çmimin për çdo normë. Formulari i ofertës, nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat sipas kërkesave të nenit 17 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, ku të jepet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij.

- Çmimi total i ofertës sonë është | 70 777 670 |; pa TVSH;
- Çmimi total i ofertës sonë është | 84 933 204 |; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
	Loti XIV – Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi per Repartin Ushitarak 1010 Vau Dejës Shkoder.	1	70 777 670	70 777 670	DERI ME 31.12.2019
Çmimi(Neto)					70 777 670
TVSH (%)					14 155 534
Çmimi Total					84 933 204

Nënshkrimi i ofertuesit

SHPRESA NIKA

-N/Kuzhinierët dhe shpërndarësit e ushqimit, nuk kanë vjetërsi në pune mbi 1 vit, sipas kërkesës së DT;

-Me certifikatën e pronësisë nuk vërtetohet pronësia e objektit, por e truallit, mungojnë të dhëna të detajuara të pronës sipas formualrit bashkëngjitur certifikatës;

-Nuk plotëson kushtin e kontratave të ngjashme të realizuara tre vitet e fundit në masë 40 % të vlerës limit të kontratës, pasi ato janë realizuar gjatë vitit 2016 dhe nuk plotësojnë vlerën në periudhën 2013, 2014 dhe 2015, përcaktuar në DT, pika 2.2.a "Kapaciteti teknik" pika 1.

Sa më sipër OE "N" shpk është kualifikuar edhe pse ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

OE "G"shpk.

-Për 3 vitet e fundit (2013-2015) OE ka realizuar xhiro sipas vërtetimit të lëshuar nga AT në shumën 38,206,470 lekë. Vlera mesatare e xhiros së tre viteve viteve të fundit është 12,735,490



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

lekë, pra më e vogël se vlera e fondit limit të lotit XIV e cila është në vlerën 76,479,226 lekë. Kjo kërkesë nuk është plotësuar dhe është në kundërshtim me kërkesat e DT pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” ku cilësohet “Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, ku vlera mesatare e xhiros gjatë 3 viteve të fundit të jetë sa vlera e fondit limit të Lotit XIV”.

Mbi ankimet: Bazuar në nenin 20, mbi procedurën e mësipërme është paraqitur ankimi sipas shtojcës 20 nga OE “G” drejtuar OQB. Pas kalimit të procedurave të ankimimit në përfundim, nga KPP është marrë vendimi nr. 05/2017 ku është vendosur pranimi i ankesës nga OE “G”, anulimi i vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e OE “N” shpk duke e s’kualifikuar nga procedura. KVO me datë 16.01.2017 ka bërë rivlerësim të procedurës dhe ka klasifikuar në vend të parë sipas vendimit të KPP-së OE “G”.

Me shkresën nr. 26/1, datë 19.01.2017 AK ka dërguar KPP-së shkresën mbi zbatimin e vendimit të saj nr. 05/2017 dhe kualifikimin e OE “G”.

Me shkresën nr. 86, datë 20.01.2017 ka dorëzuar “Formularin e ankesës pranë AK” OE “N” shpk.

Me shkresën nr. 86/1, datë 24.01.2017, DPP i ka kthyer përgjigje OE “N” shpk mbi të drejtën e tij për ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë, Tiranë.

7. Loti XV, ka rezultuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës	Vlerësimi nga KVO	Oferta ekonomike
1	Nuk ka paraqitur ofertë	-
2	Kualifikuar	39,048,660
3	Kualifikuar	36,008,520
4	Kualifikuar	37,856,201
5	Kualifikuar	39,774,450

OE “G”, nuk vërtetohet më asnjë dokument se mjeti “Furgon” 3.5 ton, është mjet frigoriferik, pasi nuk është paraqitur Certifikata e pronësisë së mjetit”.

OE “N” SHPK, nuk plotëson kërkesën mbi realizimin në masën 40% të kontratave të ngjashme, pasi dokumenton shërbim catering vetëm në vlerën 700,000 lekë. Kontratat e tjera janë kontrata shitje të mallrave ushqimore.

Operatori ekonomik i shpallur fitues, bashkimi i shoqërive “L” shpk dhe “S” shpk, plotësojnë të gjitha kërkesat dhe kanë paraqitur ofertën më vlerën më të vogël.

IV-Nga auditimi me zgjedhje i procedurës prokurimit “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh”, me fond limit 43,794,015 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të prokuruar gjithsej 42,309,380.00 lekë pa TVSH, me të dhënat e pasqyruar në tabelën nr.7, konstatohet se:

Tabela Nr. 7

Të dhëna përmbledhëse mbi procedurën “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh”

Urdhë Prokurimi nr.28 datë 15.9.2016 F. limit: 43,794,015 lekë pa TVSH	NJHD me urdhrin nr.28, datë 15.9.2016 1. 2. 3.	KVO me urdhrin nr. 28/2, datë 12.10.2016 1. 2. 3.
Procedura e prokurimit: -Tender i hapur.	Lloji i kontratës: -blerje	Burimi i Financimit: -Buxheti shtetit.
Data e hapjes së tenderit 13. 10.2016, ora 11. ⁰⁰	Afati kontratës:35 ditë nga lidhja e kontratës	S’ka

Në SPE janë paraqitur 6 Operatorë Ekonomik nga ku KVO ka kualifikuar dhe klasifikuar në vend të parë ofertën e operatorit ekonomik “E” me vlerën 42,309,380 lekë pa TVSH. Nga auditimi në SPE, konstatohet se në seancën publike të hapjes së ofertave 2 operatorë “B” dhe “P” nuk kanë paraqitur ofertë. KVO nuk ka kualifikuar ofertën e operatorit Igli-Sand, e cila rezulton të jetë me vlerën më të ulët, me arsyetimin se nuk përmbush një sërë Kërkesash të vecanta dhe të përgjithshme për kualifikim.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

Për sa sipër konstatuar, është detyrë dhe përgjegjësi KVO që në bazë të nenit 66 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime të bëjë vlerësimin e ofertës duke skualifikuar ofertën/tat që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT.

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit DPP, në cilësinë e organit qendror blerës në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 11 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 2/7, ka përcjellë në AK, njoftimin e fituesit dhe autorizimin për lidhjen e kontratës.

V.Nga auditimi me zgjedhje i procedurës prokurimit “**Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh**”, me fond limit 128,113,807 lekë (pa TVSH), me të dhënat e pasqyruar në tabelën nr.8, konstatohet se:

Në SPE janë paraqitur 7 OE, nga të cilët 4 prej tyre nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike si dhe dokumentacionin e kërkuar në DT.

Tabela nr. 8

Të dhëna përmbledhse mbi procedurën

Urdhë Prokurimi nr. 12, datë 21.03.2016 -Fondi limit 128,113,807 lekë (pa TVSH)	NJHD me urdhrin nr. 32, datë 19.09.2016 1. 2. 3.	KVO me urdhrin nr. 12/2, datë 31.03.2016 1. 2 3
Procedura e prokurimit -Procedurë e hapur.	Lloji i kontratës: -Blerje malli	Burimi i Financimit: -Buxheti shtetit.
Data e hapjes së tenderit 19.04.2016, ora 11. ⁰⁰	Afati kontratës: 45 ditë .	Ankimime në AK - 1
Formulari i njoftimit të kontratës me shkresë nr. 12/1, datë 21.03.2016, publikimi datë 24.03.2016 Formular njoftimit fituesit, shkresa nr. ...	Autorizim për lidhje kontrate për AK, me shkernë nr. 12/5, datë 26.05.2016	Procesverbali i NJHD mbi DT, datë datë 23.03.2016 Procesverbali i KVO, datë 27.04.2016 Raporti përmbledhës me shkresë nr. 12/3, datë 16.05.2016

Nga 3 prej OE janë paraqitur oferta ekonomike si më poshtë:

OE “E” shpk me ofertë ekonomike në vlerën 126,194,800 lekë (pa tvsh)

OE “M.” shpk me ofertë ekonomike në vlerën 126,831,660 lekë (pa tvsh)

OE “Dr” me ofertë ekonomike në vlerën 118,826,900 lekë (pa tvsh).

Nga grupi i auditimit u krye auditimi në SPE për ofertat e paraqitura nga OE e mësipërm dhe rezultoi se nga KVO, është vepruar në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, si dhe në zbatim të nenit 67 dhe 69, ka shpallur fitues OE “E” me ofertën ekonomike me çmimin më të ulët dhe që ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT.

OE “D” shpk dhe “A” janë paraqitur si bashkim shoqërisht por që nuk kanë plotësuar disa prej kërkesave të DT dhe janë s’kualifikuar nga gara.

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2016, DPP nuk ka kryer inventarizimin e dosjeve të prokurimit në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Konkluzione nga auditimi:

1.Në vlerësimin e ofertave KVO ka ndjekur kriterin e vlerësimit të çmimit më të ulët, duke vlerësuar në shumicë e rasteve ofertën me vlerën më të ulët, bazuar dhe në rekomandimet e mëparshme të KLSH, dërguar me shkresën nr. 606/7, datë 4.10.2016.

2.Në shumicë e rasteve në seancën publike të hapjes së ofertave të hedhura në SPE konstatohet se operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike ose dokumentacionin ligjor/teknik të kërkuar. Pjesmarrja e tyre bëhet vetëm për të siguruar konkurrencë numerike në seancëpublike të hapjes së ofertave, duke krijuar mundësinë që konkurimi të fillojë me një operator të vetëm sipas kërkesave të nenit 73, pika 1 VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime. Kjo mënyrë konkurimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues, operatorin e mbetur në garësi e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin Autoriteti Kontraktor (OQB) duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës si organ



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

kompetent i hetimit të konkurrencës së pandershme. Për pasojë, mos publikimi nga operatorët ekonomikë i ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në SPE, kur konstatohen fenomene të tilla nuk krijon kushtet për konkurrencë, nuk nxit dhe nuk inkurajon biznesin e vogël dhe të mesëm, kushti kryesor për realizimin e objektivit dhe qëllimit të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 1, si dhe direktivave të BE.

3. Në vlerësimin e ofertave ekonomike, KVO ka marrë në konsideratë dhe ka vlerësuar ofertën e paraqitur nga operatorët ekonomikë dhe pse ajo nuk është plotësuar sipas rubrikave dhe kërkesave të shtojcës 1, të DT, si dhe kërkesave të nenit 17 të ligjit nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, sipas të cilave plotësohet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij. Një veprim i tillë nga KVO nuk e përjashton atë nga detyrimet e nenit 10, dhe 14 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

4. Në disa raste KVO ka vlerësuar dhe kualifikuar operatorët ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

(Për konstatimet e mësipërme është mbajtur Aktverifikimi nr.1, datë 26.7.2017 dhe nr.2, datë 27.7.2017)

Sqarim mbi observacionet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e sipërme për akteverifikimet e mbajtura nga audituesit shtetërorë të KLSH, të cilat janë dërguar me shkresën nr.4422/6, datë 2.8.2017. Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi jep shpjegimet si më poshtë:

1. Në lidhje me procedurën e prokurimit “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarje ushqimi” me fond limit gjithsej 1, 822,592,504 lekë pa TVSH”

1.1 Për lotin VI konstatimi se “Formulari i ofertës, nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat sipas kërkesave të nenit 17 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime,, si dhe shtojcës 1 të DT. KVO ka vlerësuar se librezja e punës për M. R (B), plotëson kriterin e pikës 12, formulari “Kapaciteti teknik”,, ndërkohë që në librezën e punës figuron e larguar nga puna me datë 01.06.2000”, subjekti argumenton se: “Në ofertën e operatorit ekonomik “S”pjesë e dokumentacionitpërveç shtojcës nr.1 është hedhur edhe dokumenti i emërtuar nga vet OE-ja: “Preventiv spitali Durrës” në të cilin janë pasqyruar çmimet e detajuara të ofertës së tij siç është kërkuar në DT” dhe se “....në dokumentacionin e dorëzuar nga ky OE është sjellë librezja e plotë e punës për M.R (B) në të cilën në faqen e fundit ... ajo është e punësuar pranë shoqërisë “S”sh.p.k që nga data 22 shtator 2012 në pozicionin “Kuzhinierë”.Argumenti nuk qëndron pasi neni 17 VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, nuk lë alternativë tjetër si dhe shtojca 1(DT) duhet të ishte plotësuar sipas rubrikave që përmban, për pasojë observacioni **nuk merret** në konsideratë. Argumenti është i njëjti për të gjitha rastet e trajtuara në këtë observacion në lidhje me këtë pretendim. Në lidhje me librezën e punës të sipër cituar pasi u shqyrtua kopja e dokumentit bashkangjitur observacionit e cila **u mor** në konsideratë u pasqyrua në Projektraport.

1.2 Për lotin XXIV konstatimi se:“... Leja e qarkullimit,, nuk janë të noterizuara ..”, subjekti argumenton se:“Dokumentacioni ...është fotokopje e noterizuar bashkëlidhur kontratës së qirasë nr.275 Rep. nr.39/1 kol datë 14.06.2013 dhe nga ana e noterit publik është vendosur vula e tij në të gjitha faqet e këtyre dokumentave”.Argumenti qëndron dhe **u mor** në konsideratë nga grupi i auditimit pasi u vlerësua kopja e dokumentacionit bashkangjitur duke bërë pasqyrimet në Projektraport.

1.3 Për lotin XXV konstatimi se:“... Nga krahasimi i ofertave nga njëri lot në tjetrin rezulton që pjesmarrja e operatorëve bëhet vetëm për të siguruar konkurrencën në seancën publike të hapjes së ofertave në SPE...”, subjekti argumenton se: “Legjislacioni i prokurimeve publike në asnjë nen apo pikë të tij nuk e ka të rregulluar procedurën që duhet të ndjekë Autoriteti Kontraktor kur dyshon për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta”.Argumenti nuk qëndron me arsyetimin se:” Njohja me legjislacionin shqiptar dhe konkretisht me ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me ndryshime mundëson të drejtën për tu njohur AK për sinjalizimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve. Mos pasja dijeni për ligjin nuk e shkarkon AK nga detyrimi i njohjes. Për pasojë, pretendimi **nuk merret** në konsiderate.

1.4 “...Akt miratimi Higjeno sanitar nr.83, certifikata e pronësisë së mjetit me targë AA497 FU,.....nuk janë të noterizuara sipas kërkesave të DT.....” subjekti argumenton se: “Dokumentacioni ...është fotokopje e noterizuar bashkëlidhur kontratës së qirasë nr.3617 Rep. nr.361 kol datë 05.06.2015”. Argumenti **u mor** parasysh pas shqyrtimit të fotokopjes bashkangjitur observacionit duke u pasqyruar ndryshimet në Projektraport.

2. Për lotin XV, në procedurën Katering II, në lidhje me mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e paraqitur nga OE, sqarojmë se: *Bashkangjitur observacionit janë dhe fotokopjet e dokumentacionit I cili pasi u shqyrtua u morn ë konsideratë dhe u pasqyrua në Projektraport.*

3. Për procedurën “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh”, me fond limit 128,113, në lidhje me “*unifikimin e çmimeve dhe specifikimeve teknike, si dhe dërgimin paraprakisht AK*” sqarojmë se: Argumentet tuaja **nuk pranohen**, pasi në të gjithë pjesët e legjislacionit që edhe ju citoni, krijimi i çmimeve referuese nuk është e drejtë e OQB, por vetëm unifikimi i tyre (në rast të deviacioneve të paarsyeshme) pas marrjes së kërkesave nga OE.

6. Të tjera të dala nga procesi i auditimit.

Nga auditimi nuk konstatohet ndonjë fakt i veçantë, i cili të jetë jashtë parashikimit të pikave të programit.

Në përfundim të këtij misioni auditimi “Përputhshmërie” në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, konkludohet në dhënien e këtij:

OPINIONI TË AUDITUESVE

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200 ¹) e prokurimit të përqendruar.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë ², sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti-Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, por të përhapura si më poshtë:

Për llogaritjen e Fondit limit, nga DPP nuk ka asnjë gjurmë që tregon se është bërë verifikimi mbi angazhimin e fondeve buxhetore në dispozicion të AK-ve sipas përcaktimeve të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime, Kapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika 140 dhe 142, minimumi të kërkojë nga AK-të shkresat zyrtare të çeljes së fondeve.

¹ **1.ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim pnrputhshmërie nshtn tn japn siguri tn arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çnshetje tn veçantn nshtn në pnrputhje, në tn gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bnhet lidhur me çnshje tn veçanta.

2.ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim pnrputhshmërie nshtn tn japn siguri tn arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çnshetje tn veçantn nshtn në pnrputhje, në tn gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare

³ Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014, datn 27.11.2014 “Pnr organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

2. Mungesa e një regjistri të dhënash dhe të pa publikuar në faqen zyrtare të APP-së, që duhet të përmbajë të dhënat mbi fondin limit sipas loteve, fondin limit të prokuruar, operatorin ekonomik fitues etj. nuk mundëson transparencën dhe verifikimin e tyre, mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe fondeve në dispozicion. Ky fakt është konstatuar dhe është rekomanduar edhe nga auditimi i mëparshëm por DPP nuk e ka zbatuar këtë rekomandim të KLSH-së.

3. Hartimi i disa prej kriterëve të vecanta për “Kapacitetin Teknik”, në lidhje me “afatin e garancisë së mallit”, “ngjyrën”, “pajisjen me librezën shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shtetëror”, etj. në procedurat e prokurimit “Blerje automjete”, “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)” dhe “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, nuk janë të njëjta nga njëri lot në tjetrin dhe pse objekti i tenderimit është i njëjtë. Ky veprim nuk inkurajon pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në konkurim, pasi kriteret duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të plotësojnë kërkesat minimale të tyre sipas kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 2, pika c dhe ç, neni 20, 46 si dhe me VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 27/3.

-Në 2 procedurat e prokurimit me objekt “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, është tejkaluar objekti i kontratës nga “kontratë blerje” në “kontratë shërbimi”.Për pasojë AK në kërkesat e vecanta për kualifikim, ka përfshirë kriterë të cilat nuk janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës, duke vepruar në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

4.Në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje automjetesh” dhe “Shërbim Katering II”, operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike ose dokumentacionin ligjor/teknik të kërkuar në seancën publike të hapjes së ofertave të hedhura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Pjesmarrja e tyre bëhet vetëm për të siguruar konkurrencën numerike në seancën publike të hapjes së ofertave. Kjo mënyrë konkurimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues, operatorin e mbetur në garë si e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin Autoriteti Kontraktor (OQB) duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës si organ kompetent i hetimit të konkurrencës së pandershme. Për pasojë, mos publikimi nga operatorët ekonomikë i ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në SPE, kur konstatohen fenomene të tilla nuk krijon kushtet për konkurrencë duke mos nxitur dhe inkurajuar biznesin e vogël dhe të mesëm kushti kryesor për realizimin e objektivit dhe qëllimit të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 1, si dhe direktivave të BE.

5.Në vlerësimin e ofertave ekonomike, KVO ka marrë në konsideratë dhe ka vlerësuar ofertat e paraqitur nga operatorët ekonomikë dhe pse në disa raste ajo nuk është plotësuar sipas rubrikave dhe kërkesave të shtojcës 1, të DT, si dhe kërkesave të nenit 17 të ligjit nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, sipas të cilave plotësohet cmimi për njësi, sasia dhe cmimi në total, në mënyrë të tillë që të japë një listë të hollësishme cmimesh në ofertën e tij. Një veprim i tillë nga KVO nuk e përjashton atë nga detyrimet e nenit 10, dhe 14 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

6. Në disa raste KVO ka vlerësuar dhe kualifikuar operatorët ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Konkluzion/Opinion:

Nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

materiale, por janë devijime të konstatuara në disa raste, efektet e të cilave justifikojnë **dhënien e një opinionit të kualifikuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të auditimit, për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave të mëposhtme:

A. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

1. Nga auditimi i procedurave të prokurimit objekt “Blerje automjesh” dhe “Shërbim Katering II”, në seancën publike të hapjes së ofertave në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatohet se, operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike ose dokumentacionin ligjor/teknik të kërkuar. Për rrjedhojë sigurohet konkurrenca numerike në fazën publike të hapjes së ofertave, por jo konkurrenca në përzgjedhjen e ofertës. Kjo mënyrë konkurimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues, operatorin e mbetur në garë (pa u futur në proces konkurimi) si e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin Autoriteti Kontraktor (OQB) duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës si organ kompetent i hetimit të sjelljes anti konkurruese të operatorëve ekonomikë. Për pasojë, mos publikimi nga operatorët ekonomikë i ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në SPE, mund të kufizojnë konkurrencën e drejt dhe efektive, duke mos nxitur dhe inkurajuar biznesin e vogël dhe të mesëm kushti kryesor për realizimin e objektivit dhe qëllimit të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 1, si dhe direktivave të BE.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.26-43 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara për të kërkuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, përmirësime ligjore e cila bazuar në nenin 13, pika 2/a ka të drejtën të paraqesë në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit, për përmirësime në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, neni 73, paragrafi parë. Në një procedurë prokurimi që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit, duhet të pranohet minimumi 1 (një) ofertë e vlefshme e dalë nga konkurimi në sistem dhe jo nga publikimi në SEP të ofertës, në mënyrë që t’i pritët rruga konkurrencës fiktive nga operatorët ekonomikë, pjesmarrës të marrëveshjeve të fshehta në ofertime.

Për këtë qëllim, neni 73, paragrafi parë, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, të riformulohet duke u bërë ndryshimi si më poshtë:

Ishte:

“Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën 1(një) ofertë e vlefshme”.

Bëhet:

“Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet minimumi 1(një) ofertë e vlefshme e cila plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit”.

2. Nga auditimi ka rezultuar se disa Autoritete Kontraktore (AK), i kanë paraqitur më vonesë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin përkatës në tejkallim të afatit të përcaktuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3 (brenda datës 31 janar). Vonesat kanë shkaktuar vështirësi në zhvillimin e procedurave dhe realizimin e tyre në kohën e duhur.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.26-43 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

Për të shmangur vonesat e shkaktuara nga AK-të në paraqitjen e kërkesave sipas VKM së cituar më lart, nga OQB të kërkojë përmirësimin ligjor në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3, duke bërë ndryshimet e nevojshme si më poshtë:

Ishte:

“Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës, për çdo prokurim”.

Bëhet:

“Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës, për çdo prokurim. Në rast të tejkalimit të këtij afati, Autoritet Kontraktore gjyben”.

B. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi mbi llogaritjen e fondit limit konstatohet se nga DPP nuk ka asnjë gjurmë që tregon se është bërë verifikimi mbi angazhimin e fondeve buxhetore në dispozicion të AK-ve sipas përcaktimeve të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime, Kapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika 140 dhe 142, minimumi të kërkojë nga AK-të shkresat zyrtare të çeljes së fondeve.

Shkresat e dërguara nga Autoritet Kontraktore për fondin limit në dispozicion të tyre në shumicën e rasteve nuk kanë bashkangjitur dokumentet për llogaritjen e tij dhe për pasojë nuk ka dhe gjurmë të verifikimit të këtyre fondeve nga ana e DPP.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.10-14 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

-Të merren masa nga DPP, që në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të lërë gjurmët e saj për konfirmimin/verifikimin nga Autoritet Kontraktore mbi angazhimin e fondeve në planet e tyre buxhetore, me qëllim që llogaritja e fondit limit të mos jetë mekanike (vetëm në shumatoren e fondeve buxhetore të dërguara nga AK), por të përmbushë detyrimet ligjore që rrjedhin nga neni 60 dhe neni 2, pika 5 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime.

2.Nga auditimi mbi llogaritjen e fondit limit dhe shqyrtimit të kërkesave, të paraqitura nga Autoritet Kontraktore ka rezultuar se:

Në përcaktimin e fondit limit, Titullari i OQB ka nxjerrë urdhrin nr. 1493, datë 09.12.2015 për testimin e tregut për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”. Pas publikimit të ftesës për ofertë, 4 operatorë ekonomikë kanë dërguar ofertat së bashku me specifikimet teknike, në bazë të të cilave OQB ka përllogaritur çmimet/njësi, si mesatare e çmimit për çdo artikull. Paraqitja e kërkesave nga AK-të, duhet të bëhet deri më datë 31.01.2016 në zbatim të VKM-së nr. 28, datë 14.01.2015. Disa Autoritete i kanë sjellë me vonesë kërkesat, për rrjedhojë, nxjerrja e urdhrin të më sipërm, pa patur dijeni mbi kërkesat e AK si dhe dërgimi i këtyre “çmimeve mesatare të testuara” për referencë AK-ve, është në tejkalim të kompetencave që aktet ligjore dhe nënligjore i kanë dhënë OQB, duke vepruar në kundërshtim me:

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 2, pika 5,

-VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pikën 2, 3 dhe 4,

-udhëzimin nr. 1, datë 27.01.2015 pika 2, 3 dhe 4.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

(Trajtuar hollësisht në faqen nr.10-14 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

Titullari i Organit Qëndror Blerës, të marrë masa për ndërprerjen e një praktike të tillë, e cila është jashtë kompetencave që aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative i njohin OQB, pasi ajo, nuk ka kompetencë krijimin e manualeve të çmimeve referuese, por vetëm përpunimin, unifikimin e të dhënave të ardhura nga Autoritetet Kontraktore, duke bërë nëse është e nevojshme edhe testim të tregut pas paraqitjes së kërkesave nga AK.

3. DPP, nuk disponon një regjistër të të dhënave, i cili duhet të përmbajë të dhënat mbi fondin limit sipas loteve, fondin limit të prokuruar, operatorin ekonomik fitues etj. në mënyrë që të publikohet në faqen zyrtare të APP-së për të mundësuar transparencën dhe verifikimin e tyre, mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe fondeve në dispozicion. Ky fakt është konstatuar dhe është rekomanduar edhe nga auditimi i mëparshëm por DPP nuk e ka zbatuar këtë rekomandim të KLSH-së.

(Trajtuar hollësisht në faqen nr.10-14 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

-Të merren masa të menjëhershme nga DPP, për krijimin e një regjistri të dhënash për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik deri në njoftimin për lidhjen e kontratës, i cili të publikohet në Buletinin e APP në formën e një “regjistri realizimi të prokurimeve publike”, në mënyrë që të përmbushë funksionet e saj ligjore në cilësinë e një Autoriteti Kontraktor.

4. Nga auditimi mbi hartimin e dokumenteve të tenderit në procedurat “Blerje automjete”, “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering I)” dhe “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash” ka rezultuar se DT, kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti Teknik”, nuk janë të unifikuara dhe konkretisht në disa raste:

-pika 3, afati për “garancinë e mallit” ndryshon nga loti në lot, nga një deri në tre vjet duke sjellë mos stimulimin e operatorëve ekonomikë si dhe nuk nxit dhe nuk inkurajon pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në përputhje me nenin 46/3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 me ndryshime;

-shtojca 10, kërkohet që “ngjyra të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës”. Vendosja e këtij kriteri, është në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime;

-pika 12, në disa lote ndryshon dhe pse objekti i tendrimi është i njëjtë, si në Lotet: VI, XVII, XXVI, etj. ku kërkohet që “punonjësit të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve të kërkuara...” Mercollog/kimist/teknolog”, ndërkohë që në lotet XXV, XXVII etj. profesionet e kërkuara janë “... Mercollog/kimist”. Vendosja e kriterëve minimale të cilat ndryshojnë nga njëri lot në tjetrin dhe pse objekti i prokurimit është i njëjtë, nuk inkurajon pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në konkurim. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të plotësojnë kërkesat minimale dhe stimulojnë pjesmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 2, pika c dhe ç, neni 20, 46 si dhe me VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 27/3;

-në “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3/2 është kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim “për numrin e punëtorëve jo më pak se 25,... nga të cilët të paktën 1 punonjës të jetë inxhinier druri” dhe jo më pak se 40... për procedurën “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash” me vlerë limit të kontratës 1,822,592,504 lekë pa TVSH. Një kërkesë e tillë tejkalon objektin e kontratës e cila është “kontratë blerje” dhe jo “kontratë shërbimi”. AK nuk duhet që në kërkesat e vecanta për kualifikim, të përfshijë kriteret të cilat nuk janë në përpjestim



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

dhe të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës, por duhet të kërkojë që ata të plotësojnë kërkesat minimale sipas nenin 27/3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime;

-kërkohet në disa raste si në procedurën “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash” me fond limit 43,794,015 lekë, si kriter i vecantë kualifikimi pika 2.3/3,4,5,6 paraqitja e certifikatave ISO (9001-2008, 4001-2004, 3834-2005) dhe OHSAS 18001-2007. Referuar objektit të kontratës që “blerje” dhe jo “shërbim” vendosja e këtyre kriterëve bie në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, pasi është e tepërt dhe tejkalon objektin e kontratës. Certifikatat kanë të bëjnë jo me cilësinë e produktit por me cilësinë e menaxhimit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet evropiane, të cilat knrkohen në rastin e kontratave të shërbimit;

-Në DT, kur objekti i kontratës është “blerje malli” në kërkesat e vecanta për kualifikim kërkohet pajisja me “leje mjedisore”, pika 10 e kërkesës për kapacitet teknik (2.3).Vendosja e këtij kriteri përbën tejkalim të objektit të kontratës, pasi procedura e prokurimit ka për objekt “blerje malli” dhe jo “shërbim”, interpretimi ligjor i të cilit është trajtuar më sipër;

- Në DT të procedurës së prokurimit “Shërbim katering II”, në lotet I, II, III, IV dhe V-XV, në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” janë vendosur specifikime teknike të ndryshme për mallra të njëjtë ushqimore.

(Trajtuar hollësisht në faqen nr.14-26 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

-Të merren masa nga OQB që të bëjë unifikimin dokumenteve të tenderit në lidhje me specifikimet teknike, bazuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 4, germa (d).

5. Nga auditimi mbi hartimin e dokumenteve të tenderit ka rezultuar se:

-Në pikën 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” germa (a) ka përcaktuar si kërkesë: “Sigurimin e ofertës (nëse është e zbatueshme), sipas shtojcës 4”. Në DT nga NJHD, duhet të përcaktohet në mënyrë taksative kjo kërkesë, ose të kërkohet siguri sipas pikës 4 ku të përcaktohet vlera dhe afati, ose të mos kërkohet, kjo sipas gjykimit të NJHD. Faktin “nëse është e zbatueshme apo jo” duhet dhe është detyrë e AK dhe jo e operatorëve ekonomikë.

-Gjithashtu, në pikën 2 germa (ç) është përcaktuar ofertuesi duhet të dorëzojë “Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)”.

-Pjesë e DT janë edhe shtojcat mbi marrëveshjen kuadr, ku nuk është e nevojshme pasi, në Urdhë Prokurim është përcaktuar lloji i procedurës, pra “tender i hapur”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.22 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

-Të merren masa nga Njësia për Hartimin e Dokumenteve të tenderit që në të ardhmen dokumentet të hartohen në përputhje me objektin e tenderimit, llojin e procedurës së prokurimit, duke mbajtur të pandryshuar ato kriteret që janë të përcaktuara në DST, me qëllim që të përshtaten rast pas rasti.

-Në DT, të përcaktohet në mënyrë taksative nëse është i detyrueshm siguri i ofertës, ku të përcaktohet vlera dhe afati, në të kundërt ky formular të mos jetë pjesë e DT.

-Në përcaktimin e DT, mbështetur në DST “Për mallrat” të hartohen dhe të vendosen kërkesa në përputhje me llojin e prokurimit dhe të kontratës.

6. Për lotin IV, sipas DT, për tenderin “Blerje mjjetesh” subjekti “Porsche Albania” ka paraqitur autorizim prodhuesi, ku afati i marrëveshjes së lidhur prodhuesin mban datën 27.11.2006 dhe në kapitullin XII “Kushtet dhe zgjidhja e marrëveshjes” cilësohet: “Kjo marrëveshje do të hyjn në fuqi me nënshkrimin nga palët në marrëveshje dhe zgjidhet për një periudhn kohore të pacaktuar”. Sa më sipër, pavarësisht paraqitjes së marrëveshjes, AK nuk mund të dijë nëse kjo marrëveshje me



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI USHTUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

prodhuesin është efektive në momentin e zhvillimit të procedurës së konkurrimit apo jo. Nisur nga kjo në DT, duhej të kërkohej edhe deklarata me shkrim nga prodhuesi dhe së paku nga operatori ekonomik, ku të shprehen se marrëveshja në fjalë është në fuqi.

(Trajtuar hollësisht në faqen nr.26-43 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

Nga OQB, në raste të tilla ku afati i marrëveshjeve është i papërcaktuar, të kërkohej që nga OE, bashkëngjitur marrëveshjeve të paraqitet një deklarata e lëshuar prej palëve, ku të cilësohet se gjatë periudhës së procedurës marrëveshja vazhdon të jetë efektive.

7. Nga auditimi i DT për procedurën “Shërbim cateringu” ka rezultuar se në disa raste nga OQB, nuk janë përfshirë disa kërkesa të rëndësishme të paraqitura nga AK, konkretisht:

-pika 2.3, nuk ka të përcaktuar si klauzolë dokumentet (kontratën e qirasë mes operatorit ekonomik fitues dhe AK) që duhet të paraqesë operatori ekonomik në rastet kur Autoriteti Kontraktor kërkon që gatimi, përgatitja, shpërndarja dhe servirja e ushqimeve do të bëhet detyruesisht në ambientet (kuzhinën/mensën e repartit) e tij të cilat janë detyruese për lotet II, III, XVII XXIVetj. Vendosja e një kriteri të tillë është e detyrueshme pasi lidhet me kërkesat e paraqitura nga Autoritet Kontraktore, sidomos nga reparte ushtarake;

-pika 11, për personelin e kuzhinës dhe konkretisht për punonjësit me profesione: kuzhinier, mercolog/kimist/teknolog, ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, nuk është kërkuar që të paraqesin librezën shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, sipas nenit 21 të ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror” me ndryshime, edhe pse është kërkesë e AK. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.17 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandojmë:

Të merren masa të menjëhershme nga OQB që të përfshijë në DT të gjitha kërkesat e AK, të cilat kanë rëndësi dhe janë të lidhura drejtpërsëdrejti me cilësinë e shërbimit apo mallit të prokuruar.

8. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, konstatohet: Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara me shkresën nr.3624/25, datë 03.4.2017 ka kthyer përgjigje shkresës së KLSH nr.606, datë 4.10.2016 për dërgim rekomandimesh. Nga zbatimi i rekomandimeve rezulton se DPP ka pranuar rekomandimet, ka nxjerrë urdhrin për zbatimin e tyre dhe ka hartuar planin e veprimeve dhe në përfundim gjendja për zbatimin e rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

-Rekomandime “Propozime për përmirësime në legjislacionin në fuqi” janë propozuar 5 masa të cilat janë pranuar nga DPP duke u përcjellë me shkresë në APP e cila nuk i ka pranuar me argumentin përkatës për cdo rekomandim.

-Rekomandime “Masa organizative” janë propozuar 6, të cilat janë pranuar nga DPP dhe janë zbatuar 4 masa. Rekomandimi nr. 2, për krijimin e një regjistri me të dhëna mbi kërksat e autoriteteve kontraktore (sasinë e mallrave, punëve apo shërbimeve të kërkuara, fondi limit i parashikuar, fondi limit sipas urdhrin të nxjerrë, vlera e shpallur fituese, emri i operatorit fitues etj.) nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore si dhe rekomandimi nr.6, mbi arkivimin e dosjeve të tenderave zhvilluar në vitin 2015 nuk është zbatuar.

-Rekomandim “Masa për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike” janë propozuar 3, të cilat janë zbatuar.

-Rekomandime “Masat disiplinore” janë propozuar 8 të cilat janë pranuar nga DPP dhe janë marrë në shqyrtim për fillimin e procedurave disiplinore. Në përfundim me vendimet Nr. 2259/4, datë 23.03.2017, Nr. 2259/5, datë 23.03.2017, Nr. 2259/6, datë 23.03.2017, Nr. 2259/7, datë 23.03.2017, Nr. 2259/8, datë 23.03.2017, Nr. 2259/9, datë 23.03.2017, Nr. 2259/10, datë 23.03.2017, Nr. 2259/11, datë 23.03.2017 është vendosur mos fillimi i procedimit disiplinor ndaj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI USHTRUAR NË DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TIRANË

tyre, pasi gjykohet se punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi nga KLSH, kanë vepruar në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Rekomandimet e KLSH për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësve nuk janë zbatuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.7-9 të Raportit të Auditimit).

Rekomandojmë:

-Me qëllim përmirësimit e gjendjes, të përsëritet zbatimi i rekomandimeve që nuk janë zbatuar, të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH dërguar me shkresën nr.606, datë 4.10.2016 dhe konkretisht rekomandimi nr.6 “Masa organizative” sipas të cilës “OQB të marrë masat për të arkivuar dosjet e tenderave të zhvilluar gjatë vitit 2015 dhe 2016 sipas përcaktimeve të ligjit “Mbi arkivat” si dhe rekomandimet për “masa disiplinore” ndaj 8 punonjësve të ngarkuar me përgjegjësi.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI LARTË I SHTETIT